

PËR MËSUESIN/EN

duk^agjini
shtëpia botuese publishing house

**Mimoza Lipaj, Ardora Morina,
Dorentina Trolli, Shqiponja Kamberi**

SHOQËRIA DHE MJEDISI

Për klasën e parë të arsimit fillor

1

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes.....	5
Hyrje.....	7
Planifikimi vjetor.....	15
Plani dymujor: shtator—tetor.....	16
Plani dymujor: nëntor—dhjetor.....	19
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	22
Plani tremujor: prill—maj—qershor.....	25
Mësimi 1: Unë jam.....	28
Mësimi 2: Familja ime.....	30
Mësimi 3: Familja ime është e madhe.....	32
Mësimi 4: Në familje punojnë të gjithë.....	34
Mësimi 5: Unë dhe shoqëria ime.....	36
Mësimi 6: Unë dhe të tjerët.....	38
Mësimi 7: Kam nevojë për të tjerët.....	40
Mësimi 8: Unë ndiej.....	42
Mësimi 9: Unë marr përgjegjësi.....	44
Mësimi 10: Nevojat dhe dëshirat tona.....	46
Mësimi 11: Unë banoj.....	48
Mësimi 12: Unë jetoj.....	50
Mësimi 13: Rreziqet në shtëpi.....	52
Mësimi 14: Jeta <i>dikur</i> dhe <i>sot</i>	54
Mësimi 15: Mjetet e punës.....	56
Mësimi 16: Mjetet e transportit.....	58
Mësimi 17: Mjetet e komunikimit.....	60
Mësimi 18: Një vizitë në muze.....	62
Mësimi 19: Rregullat në familje.....	64
Mësimi 20: Rregullat në shkollën tonë.....	66
Mësimi 21: Rregullat në mjedise të ndryshme.....	68
Mësimi 22: Jemi të ndryshëm, por të barabartë.....	70
Mësimi 23: I respektoj rregullat në lojë.....	72
Mësimi 24: Respektojmë njëri-tjetrin.....	74
Mësimi 25: Ndihmojmë njerëzit në nevojë.....	76
Mësimi 26: Veprojmë së bashku - kujdesi në rrugë.....	78
Mësimi 27: Ditët e festave.....	80
Mësimi 28: Festat në familjen time.....	82
Mësimi 29: Fjala ime ka vlerë.....	84
Mësimi 30: Bashkëpunojmë dhe marrim vendime.....	86
Mësimi 31: Ta mbrojmë mjedisin nga ndotja.....	88
Mësimi 32: Kujdesi ndaj mjedisit.....	90
Mësimi 33: Kujdesem për mjedisin ku jetoj.....	92
Mësimi 34: Kujdesem për mjedisin në shkollë.....	94
Mësimi 35: Bashkëpunojmë për një mjedis të pastër.....	96
Mësimi 36: Provoj veten.....	98
Mësimi 37: “Loja me zare”.....	100

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimit. Sot është mundësia që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimit ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimit dhe të nxënësve, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e nxënësve dhe mësimit përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lypet të përdorni metoda dinamike të mësimit, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES

për konceptimin e mësimave model

Faqja në të majtë

- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Rezultatet e të nxënit të temës janë në koherencë me ato të fushës.
- Mësimi synon që përmes rezultateve të të nxënit, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.



Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.


Të gjitha mjetet dhe materialet që ndihmojnë në konkretizim.

Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentohen.

Metodologjia e mëimit ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathtësi të reja.

Faqja në të djathtë

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Figurat, tabelat, diagramet etj., janë ndihmë për të gjithë mësuesit/et në aspektin pamor, për sukses në zhvillimin e mëimit.
- Për t'i përforcuar dijet dhe shkathtësitë, në fund të mëimit jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mëimit, ku përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënësit bëhet më tërheqës dhe nxënësit bëhen aktivë, duke u përfshirë në veprimtari të ndryshme.

Veprimtaritë në këtë hap a këta hapa të mëimit udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Hapi i fundit është praktikë e pavarur ku nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe inkurajohen duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mëimit

Rezultatet e të nxënit të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese për përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënit për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon për arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihet të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënësve: Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimi, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës e që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zbërthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënësit - hapat e zhvillimit të mësimi: Meqenëse nxënësit e klasës së parë dhe të dytë mësojnë konceptet dhe shkathtësitë fillestare, në këtë fazë të zhvillimit ata përparojnë në drejtim të zotërimit të tyre, por nuk i zotërojnë operacionet mendore, prandaj edhe të menduarit e tyre është paraoperacional, kështu që mësimi kalon përmes hapave.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit?



Mbillet një farë në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera.

Këto tri figura jepen së bashku, njëra pas tjetrës, çka sugjeron që mësuesi duhet të ndërtojë mësimin mbi të mëparshmen dhe të ketë parasysh se çfarë mund të vijojë. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.

Në këto klasa mësimi zhvillohet në hapa, të cilët sipas lëndës dhe veçorisë, mund të jenë tre ose edhe më shumë, por gjithsesi mësimi do të ndjekë këtë ecuri.

Hyrje: Identifikohen njohuritë dhe shprehjet fillestare të nxënësve që të nxiten interesi i tyre për mësimin.

Pjesa kryesore e mësimi: Mësuesi/ja përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, synon ta bëjë tërheqës të nxënësve të mësimi përmes veprimtarive të ndryshme, duke përdorur mjete të larmishme konkretizuese, figura, tabela, fotografi, video dhe të tjera.

Praktikë e udhëhequr: Veprimtaritë në këtë etapë të mësimi kërkojnë që të udhëhiqen nga mësuesi dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve a duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Praktikë e pavarur: Nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë por tashmë të pavarur dhe nxiten duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

SHOQËRIA DHE MJEDISI 1

Njohuritë nga fusha *Shoqëria dhe mjedisi* janë pjesë e mozaikut të gjerë të përbërë nga fushat kurrikulare, përmes të cilave nxënësi arrin qëllimet e përcaktuara në Kornizën Kurrikulare. *Shoqëria dhe mjedisi* është njëra nga shtatë fushat kurrikulare të parapara në Kornizën Kurrikulare, e cila zhvillon te nxënësi njohuritë, shkathtësitë dhe kultivon vlerat dhe qëndrimet demokratike individuale e shoqërore, duke zhvilluar prirjet e qytetarit të përgjegjshëm për proceset shoqërore e mjedisore. Kjo fushë e ndihmon nxënësin për të zhvilluar të kuptuarit e tij për botën, për njerëzit, për vlerat, për proceset mjedisore në kohë dhe hapësirë, në vende dhe rrethana të ndryshme. Njohuritë nga kjo fushë gjithashtu mundësojnë që nxënësi të kultivojë identitet personal, shoqëror, kulturor, shtetëror e kombëtar, të kultivojë të mësuarit për të jetuar së bashku me të tjerët si dhe edukimin për zhvillim të qëndrueshëm.

Në fushën *Shoqëria dhe mjedisi*, mësimi realizohet me përmbajtje të integruara, përmes rezultateve të cilat e përcjellin zhvillimin njohës psikofizik dhe emocional të nxënësi, duke zhvilluar tek ai tiparet e qytetarit të përgjegjshëm, krijues dhe vendimmarrës.

Udhëzime metodologjike

Për të realizuar qëllimet e kurrikulës, përmes fushës *Shoqëria dhe mjedisi*, këshillohet përdorimi i metodave të ndryshme që plotësojnë njëra-tjetrën dhe që mundësojnë zhvillimin e të menduarit kritik e krijues të nxënësi, për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive në situata të ndryshme.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësuesit të fushës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes tematike mësimore dhe të rezultateve të kompetencave për shkallën e parë kurrikulare, me bazën didaktike dhe me nivelin e formimit të nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë maksimumin e potencialit që zotëron brenda vetes.

Mësuesi është i lirë të përdorë metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash. Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Metodatat dhe teknikat e punës me nxënës lypet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, në funksion të arritjeve të rezultateve të të nxënës dhe të zbatimit në jetën e përditshme.


Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënës

Ky libër është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese për ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai i trajton temat mësimore në përputhje me "Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës" (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënës të fushës, rezultatet specifike të të nxënës të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimi e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*.

Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe mossuksesin, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi është treguar kujdes

i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënës - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënës - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “trekëndësh magjik”. Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënës, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënës dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë për ndërtimin e dijes dhe të shkathhtësive.



Burimi: Metodologji e mësimdhënies, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014)

Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënës, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psi-

kologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve për ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënës e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshtarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e Zhvillimit Proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshtar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Sipas Piazhësë, fëmijët e klasës së parë dhe të dytë bëjnë pjesë në stadin paraoperacional dhe proceset kryesore të të menduarit tek ata bazohen kryesisht në vëzhgim. Në këtë mënyrë, është e mundur të kultivohen elementet dhe shprehitë e para të të menduarit kritik; por edukimi në mënyrë sistematike i tyre, që bëhet më pas shprehi e rëndësishme e të menduarit të nivelit të lartë, fillon në klasën e tretë. Për këtë arsye, mësimet janë të strukturuar në disa hapa të thjeshtë, të cilët me kujdes dhe në mënyrë të përshkallëzuar kontribuojnë, japin ndihmesën e tyre për ndërtimin dhe krijimin e dijeve, si dhe formimin e shprehive.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
2.	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minuta.
4.	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
5.	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimi, vizatimi, dramatizimi (luajtja në role), këndimi apo vallëzimi.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
7.	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore, si dhe e prezanton para të tjerëve.
8.	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo interpretimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.
9.	Emërton në gjuhën e huaj objekte, veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e tij.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
5.	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.
6.	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën në një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta.

III. Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm	
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkohet zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkohet këshilla/informacione kur has në vështirësi.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
1.	Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre.
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
3.	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
4.	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
6.	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anashjell në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
1.	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
3.	Bën një listë (me njërën nga format shprehëse, si, shkrim, vizatim etj.) me ushqimet të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.
4.	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
6.	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
1.	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë.
2.	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
3.	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
4.	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
5.	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe përshkruan, përmes formave të ndryshme të shprehjes, kontributin individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
7.	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilat kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi/ja apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

Rezultatet e të nxënës të fushës Shoqëria dhe mjedisi, **Shkalla 1**

1. NJOHURITË, TË KUPTUARIT, SHKATHTËSITË përmes të cilave nxënësi/ja:	
1.	Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to.
2.	Tregon (rrëfen) për vetveten, familjen e ngushtë dhe të gjerë (dallon moshën dhe prejardhjen), rrethin ku jeton e vepron si dhe organizimin e hapësirës së banimit dhe veprimit, migrimet, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike.
3.	Dallon disa aspekte të shprehjes së identitetit personal dhe grupor, si: fizik, psikologjik, kulturor, social, administrativ, me qëllim ndërlidhjeje me të tjerët, pavarësisht dallimeve.
2. Njeh rëndësinë e monumenteve, dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore e mjedisore si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre:	
1.	Përshkruan ngjarje shoqërore, kulturore dhe historike si dhe dukuri natyrore e mjedisore përmes shembujve nga jeta e përditshme dhe nga e kaluara.
2.	Kupton proceset dhe dukuritë e ndryshme shoqërore dhe natyrore dhe ndërvlerësinë e njeriut me natyrën.
3. Njeh dhe mëson të zbatojë normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet:	
1.	Identifikon dhe respekton traditat dhe festat si pasqyrim i llojllojshmërisë kulturore, fetare, shoqërore, etnike e familjare.
2.	Merr pjesë për caktimin e rregullave për jetën personale (kohën e punës, argëtimit, vizitave, pushimit dhe gjumit), rregullave të familjes, të shkollës dhe grupeve ku ai është i përfshirë dhe u përmbahet atyre.
4. Përfshihet në dhënien e ideve, propozimeve dhe merr vendime në mënyrë të përgjegjshme:	
1.	Demonstron vetëbesim dhe merr vendime për çështje që lidhen me situata nga jeta e përditshme, në përputhje me moshën si individ dhe si anëtar i një grupi (familja, shkolla etj.)
5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm:	
1.	Njeh dhe dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm, në rrethin ku jeton dhe kupton rolin që ka në ruajtjen e mjedisit.
2.	Kupton ndërlidhjen e mirëqenies personale e shoqërore në raport me kujdesin ndaj mjedisit.
6. Shfrytëzon në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore:	
1.	Përdor TIK-un dhe medien që të pajiset me informacione të përshtatshme për moshën lidhur me shoqërinë dhe mjedisin.
2.	Ushtron operacione themelore në përdorimin e TIK-ut për nevojat e tij shkollore.

II. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen te nxënësi/ja:

- Respekti për të tjerët
- Vetërespekti
- Barazia
- Toleranca
- Mirëkuptimi (për tjetrin ndryshe)
- Reagimi (ndaj dukurive negative)
- Empatia
- Altruizmi
- Gjykimi i drejtë
- Kujdesi për mjedisin
- Solidariteti
- Qëndrimi miqësor ndaj shoqërisë dhe mjedisit
- Kujdesi për trashëgiminë

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja:

- Shfrytëzim i burimeve
- Krijim i modeleve
- Diskutimi
- Matja
- Skicimi
- Ndërtim dhe lexim i grafikëve, diagrameve, tabelave dhe hartave
- Përdorimi me vend i informacioneve
- Hulumtimi
- Përdorimi i saktë i termave të mësuar

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi
Klasa I

Lëndët e fushës kurrikulare		TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënित për kompetencat kryesore të shkallës I (Klasa I).	
		GJYSMËVJETORI I		GJYSMËVJETORI II			
		shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor		
SHOQËRIA DHE MJEDISI 1	Familja ime	Shtëpia ime Mënyra e jetesës dikur dhe sot	Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri Festat	Unë vendos së bashku me të tjerët Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qëndrueshëm	I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv 1, 3, 4, 5, 6, 7.	
					II	Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8.	
					III	Kompetenca e të nxënित – Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.	
					IV	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6.	
					V	Kompetenca personale – Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.	
					VI	Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.	
	10 orë	8 orë	10 orë	9 orë			

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: I

Tema mësimore: Familja ime

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

- | | |
|-----|--|
| I.3 | Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minuta; |
| I.7 | Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore, si dhe e prezanton para të tjerëve. |

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

- | | |
|------|--|
| II.7 | Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës, në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna. |
| II.8 | Arsyeton para grupit mënyrën e zgjedhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fushat e tjera, në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. |

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

- | | |
|-------|---|
| III.2 | Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërko-het prej tij/saj. |
| III.3 | Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit. |
| III.6 | Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale. |

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

- | | |
|------|--|
| IV.2 | Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). |
| IV.3 | Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar. |
| IV.4 | Gjen të përbashkëta dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup. |

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

- | | |
|-----|--|
| V.5 | Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitete në klasë/shkollë apo jashtë saj. |
|-----|--|

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

- | | |
|------|--|
| VI.1 | Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë. |
| VI.6 | Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar. |

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Tregon (rrëfen) për vetveten, familjen e ngushtë dhe të gjerë (dallon moshën dhe prejardhjen), rrethin ku jeton e vepron si dhe organizimin e hapësirës së banimit dhe veprimit, migrimet, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike.
1.2	Dallon disa aspekte të shprehjes së identitetit personal dhe grupor, si: fizik, psikologjik, kulturor, social, administrativ, me qëllim ndërlidhjeje me të tjerët, pavarësisht dallimeve.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Familja ime	Tregon për vetetveten, disa prej karakteristikeve të tij/saj (p.sh. gjininë, moshën, prejardhjen dhe vendin ku jeton etj.). Përshkruan strukturën/përberjen e familjes, familjen e ngushtë dhe të gjerë, si dhe identifikon moshën dhe prejardhjen e tyre. Dallon rolet e anëtarëve të familjes dhe shpjegon se si ata kontribuojnë në jetën e përbashkët familjare. Flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të anëtarëve brenda familjes.	- Unë jam..., fq. 6-7 - Familja ime, fq. 8 - Familja ime është e madhe, fq. 9 - Në familje punojnë të gjithë, fq. 10 - Unë dhe shoqëria ime, fq. 11-12 - Unë dhe të tjerët, fq. 13 - Kam nevojë për të tjerët, fq. 14 - Unë ndiej..., fq. 15 - Unë marr përgjegjësi, fq. 16 - Nevojat dhe dëshirat tona, fq. 17-18	10	Mësimdhënia dhe nxënja e bazuar në kompetenca Mësimdhënia dhe të nxënëti e integruar Mësimdhënia dhe të nxënëti e diferencuar Teknikat: 1. Stuhi mendimesh 2. Dramatizim me role 3. Rrjet diskutimi	Vlerësimi formativ Vlerësimi i të nxënëti Informata kthyesë Listë kontrolli Portfolio	Gjuhë shqipe Matematikë Shkencat e natyrës Shkathësi për jetë Edukimi për qytetari demokratike Edukimi për mjedis	Shoqëria dhe mjedisi 1 Shoqëria dhe mjedisi 1 F.P. <i>Dukagjini</i> Burime të marra nga interneti

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: I

Temat mësimore: Shtëpia ime

Mënyra e jetesës dikur dhe sot

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv
I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minuta.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.3	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohej prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.3	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
IV.4	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.6	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë.
VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
VI.3	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit temës/temave:

2.1	Përshkruan ngjarje shoqërore, kulturore dhe historike si dhe dukuri natyrore e mjedisore përmes shembujve nga jeta e përditshme dhe nga e kaluara.
2.2	Kupton proceset dhe dukuritë e ndryshme shoqërore dhe natyrore dhe ndërvarësinë e njeriut me natyrën.
3.1	Identifikon dhe respekton traditat dhe festat si pasqyrim i llojllojshmërisë kulturore, fetare, shoqërore, etnike e familjare.
3.2	Merr pjesë për caktimin e rregullave për jetën personale (kohën e punës, argëtimit, vizitave, pushimit dhe gjumit), rregullave të familjes, të shkollës dhe grupeve ku ai është i përfshirë dhe u përmbahet atyre.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënës për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Shtëpia ime	Tregon për rëndësinë e shtëpisë në ofrimin e sigurisë dhe ngrohjes familjare, për funksionin të një jete normale dhe mirëqenies së tij dhe antarëve të tjerë të familjes në të. Identifikon hapësirat e ndryshme të shtëpisë dhe diskuton për funksionin e tyre.	1. Unë banoj..., fq. 19 2. Unë jetoj..., fq. 20 3. Rreziqet në shtëpi, fq. 21 4. Jeta <i>dikur</i> dhe sot, fq. 23-24 5. Mjetet e punës, fq. 25 6. Mjetet e transportit, fq. 26 7. Mjetet e komunikimit, fq. 27 8. Një vizitë në muze, fq. 28	8	Mësimdhënia dhe nxënësia e bazuar në kompetenca Mësimdhënia dhe të nxënës të integruar Mësimdhënia dhe të nxënës të diferencuar Teknikat: 1. Stuhi mendimesh 2. Dramatizim me role 3. Rrjet diskutimi	Vlerësimi formativ Vlerësimi i të nxënës Informata kthyes Listë kontrolli Portfolio	Gjuhë shqipe Matematikë Shkencat e natyrës Shkathësi për jetë Edukimi për qytetari demokratike	Shoqëria dhe mjedisi 1 Shoqëria dhe mjedisi 1 F.P. <i>Dukagjini</i> Burime të marra nga interneti
Mënyra e jetesës dikur dhe sot	Tregon se si jeta e familjarëve dhe mjedisi i tyre mund të kenë qenë të ndryshme në të kaluarën me ato të sotmet. Identifikon aspekte të ndryshme të jetesës së njerezve (kulturore, shoqërore etj.) në të kaluarën dhe sot. Emërton disa nga gjërat dhe veglat që janë përdorur në të kaluarën dhe tregon se çfarë përdorim sot në vend të tyre (qepja me gjilpërë – makina për qepje, lërimi i tokës me kafshë – lërimi me traktor dhe mjete të tjera, mjetet e transportit, komunikimit etj.). Dallon ndryshimet në mjedisin përreth, të shkaktuara nga njeriu.						

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: I

Temat mësimore: Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri
Festat

RNK- Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minuta;
I.4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
I.5	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njëres nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimi, vizatimi, dramatizimi (luajtja në role), këndimi apo vallëzimi.
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre.
II.5	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njëres prej tyre në njërin nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.
II.7	Ndërtton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta.

Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjat, ngjyrat, numëratoren etj. për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohej prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.5	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
III.7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.3	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
IV.4	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.1	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit të vet në të cilin jeton dhe vepron.
V.2	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan paanshëm si dhe menaxhon emocionet e veta, si në rastet e fitores, ashtu edhe të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.6	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.1	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarët.
VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
VI.3	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
VI.4	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
VI.7	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilat kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

RNF- Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
3.1	Identifikon dhe respekton traditat dhe festat si pasqyrim i llojllojshmërisë kulturore, fetare, shoqërore, etnike e familjare.
3.2	Merr pjesë në caktimin e rregullave për jetën personale (kohën e punës, argëtimit, vizitave, pushimit dhe gjumit), rregullave të familjes, të shkollës dhe grupeve ku ai është i përfshirë dhe u përmbahet atyre.
4.1	Demonstron vetëbesim dhe merr vendime për çështje që lidhen me situata nga jeta e përditshme, në përputhje me moshën si individ dhe si anëtar i një grupi (familja, shkolla etj.).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri	- Përshkruan dhe respekton rregullat e caktuara të veprimtarive të ndryshme që zhvillohen në familje, në klasë dhe në shoqëri. - Kontribuon dhe arsyeton rëndësinë e vendosjes së rregullave të nevojshme, në bashkëpunim me të tjerët, për veprimtaritë e tij të përditshme në familje, shkollë dhe shoqëri.	- Rregullat në familje, fq. 29, 30 - Rregullat në shkollën tonë, fq. 31 - Rregullat në mjediset e ndryshme, fq. 33 - Jemi të ndryshëm, por të barabartë, fq. 34 - I respektoj rregullat në lojë, fq. 35 - Respektojmë njëri-tjetrin, fq. 36 - Ndihmojmë njerëzit në nevojë, fq. 37 - Veprimtari në bashku - kujdesi në rrugë, fq. 38, 39 - Ditët e festave, fq. 40 - Festat në familjen time, fq. 41	10	Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca Mësimdhënia dhe të nxënësit integruar Mësimdhënia dhe të nxënësit e diferencuar Teknikat: 1. Stuhi mendimesh 2. Dramatizim me role 3. Rrjet diskutimi	Vlerësimi formativ Vlerësimi i të nxënësve Informata kthyesë Listë kontrolli Portfolio	Gjuhë amtare Matematikë Shkencat e natyrës Shkathësi për jetë Edukimi për qytetari demokratike	Shoqëria dhe mjedisi 1 Shoqëria dhe mjedisi 1 F.P. <i>Dukagjini</i> Burime nga interneti
Festat	- Përshkruan dhe respekton rregullat e caktuara të veprimtarive të ndryshme që zhvillohen në familje, në klasë dhe në shoqëri. - Kontribuon dhe arsyeton rëndësinë e vendosjes së rregullave të nevojshme, në bashkëpunim me të tjerët, për veprimtaritë e tij të përditshme në familje, shkollë dhe shoqëri.	- Rregullat në familje, fq. 29, 30 - Rregullat në shkollën tonë, fq. 31 - Rregullat në mjediset e ndryshme, fq. 33 - Jemi të ndryshëm, por të barabartë, fq. 34 - I respektoj rregullat në lojë, fq. 35 - Respektojmë njëri-tjetrin, fq. 36 - Ndihmojmë njerëzit në nevojë, fq. 37 - Veprimtari në bashku - kujdesi në rrugë, fq. 38, 39 - Ditët e festave, fq. 40 - Festat në familjen time, fq. 41					

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: I

Tema mësimore: Unë vendos së bashku me të tjerët
Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qëndrueshëm

RNK- Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minuta;
I.4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
I.6	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
I.7	Përshkruan në formë të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.6	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën në një gjysmë faqeje të fletore (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërin nga format shprehëse.
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta.

Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm

III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohej prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.7	Identifikon njohuritë e veta e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.4	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njëres nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.1	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësëd-eve personale) dhe të higjienës së mjedisit të vet në të cilin jeton dhe vepron.
V.4	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.5	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.
VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

RNF- Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

4.1	Demonstron vetëbesim dhe merr vendime për çështje që lidhen me situata nga jeta e përditshme, në përputhje me moshën si individ dhe si anëtar i një grupi (familja, shkolla, etj.).
5.1	Njeh dhe dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm, në rrethin ku jeton dhe kupton rolin që ka në ruajtjen e mjedisit.
5.2	Kupton ndërlidhjen e mirëqenies personale e shoqërore në raport me kujdesin ndaj mjedisit.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënës për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Unë vendos së bashku me të tjerët	Merr vendime për situata të ndryshme jetësore në grup, në klasë, në familje, në raport me moshën e tij/saj.	1. Fjala ime ka vlerë, fq. 42 2. Bashkëpunojmë dhe marrim vendime, fq. 43 3. Ta mbrojmë mjedisin nga ndotja, fq. 44	9	Mësimdhënia dhe nxënësia e bazuar në kompetenca	Vlerësimi formativ	Gjuhë amtare Matematika	Shoqëria dhe mjedisi 1
Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qëndrueshëm	Sqaron në forma të ndryshme shprehëse vendimet e veta dhe të grupit, gjatë lojës dhe aktiviteteve të ndryshme në familje, në shkollë etj. Arsyeton rëndësinë e marrjes së vendimeve të përbashkëta për aktivitete të ndryshme në klasë dhe në mjedise të ndryshme ku vepron. Demonstron gatishmërinë për të ndjekur rregullat e higjienës personale dhe të mjedisit në veprimtaritë e përditshme në familje, klasë, lagje, shkollë etj. Identifikon ndotësit kryesorë të mjedisit ku jeton (klasë, shkollë, lagje etj.) dhe demonstroi shkathtësi, në vazhdimësi, për mirëmbajtjen e tij. Jep shembuj për ndikimin e njeriut në mbrojtjen dhe dëmtimin e mjedisit përreth. Vlerëson veprimet e veta që mund të ndikojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.	4. Kujdesi ndaj mjedisit, fq. 45 5. Kujdesem për mjedisin ku jetoj, fq. 46 6. Kujdesem për mjedisin në shkollë, fq. 47 7. Bashkëpunojmë për një mjedis të pastër, fq. 48 8. Provoj veten, fq. 49, 50 9. “Loja me zare”, fq. 51		Mësimdhënia dhe të nxënësit e integruar Mësimdhënia dhe të nxënësit e diferencuar Teknikat: 1. Stuhi mendimesh 2. Dramatizim me role 3. Rrjet diskutimi	Vlerësimi i të nxënësve Informata kthyes Listë kontrolli Portfolio	Shoqëria dhe mjedisi Të drejtat e fëmijëve Çështjet ndërkurrikulare	Shoqëria dhe mjedisi 1 F.P. <i>Dukagjini</i> Burime nga interneti

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për vetveten disa prej karakteristikave të tij/saj (p.sh. gjininë, moshën, prejardhjen dhe vendin ku jeton etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 7, III.2, 3, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë jam...

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Prezanton veten para klasës;
- Gjen fjalë që fillojnë me shkronjën e emrit të shokut a shoqes;
- Rrumbullakon numrin e moshës;
- Shpreh lirshëm mendimin e vet për kuptimin e emrit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Lapsa me ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Ora fillon me prezantimin e lojës që do të zhvillohet. Ashtu të ulur nëpër banka do të tregojnë emrin e tyre, dhe shoku a shoqja që është afër tij do të gjejë një fjalë e cila fillon me shkronjën e parë të emrit të shokut/shoqes.

Nxënësit duhet të mbajnë në mend, p.sh.: Klea-krijuese, Dea-dashuri. Kështu vazhdon veprimtaria deri te nxënësi i fundit. Përpiqen që gjatë orës mësimore ta thërrasin njëri-tjetrin me emrin që ia kanë vënë.

Hapi 2: Në libra nxënësit rrumbullakojnë numrin e moshës së tyre, po ashtu ngjyrosin edhe katrorët e zbrazët me ngjyrën e syve që kanë.





Të flasim për:
- anëtarët e familjes;
- datëlindjen;
- vendlindjen;
- vendbanimin.

Unë kam të drejtë
të kem një emër!

Unë jam...

Kush ta ka
vënë emrin?



7

Hapi 3: Parashtrohen pyetje të cilat i nxisin nxënësit që të tregojnë për veten, si p.sh.: emrin dhe mbiemrin, anëtarët e familjes, ditëlindjen, vendlindjen dhe vendbanimin.

Hapi 4: Të gjithë nxënësit që e dinë se kush ia ka vënë emrin, tregojnë për domethënien e emrit të vet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pasurinë e fjalorit në prezantimin e vetes dhe shprehjen lirshëm të mendimeve.

Detyrë:

Detyra: Plotëson në fletore pune.

Bisedon me prindërit për kuptimin e emrit të vet dhe se kush ia ka vënë atë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për vetveten disa prej karakteristikave të tij/saj (p.sh. gjininë, moshën, prejardhjen dhe vendin ku jeton etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 7, III.2 ,3, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1 ,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton anëtarët e familjes;
- Dallon familjen e ngushtë (nënë, babanë, motrën, vëllanë);
- Tregon për profesionin e prindërve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fototografi të familjes së ngushtë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjdhjet dhe komunikimi, Artet, Matematika, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet bisedë duke parashtruar pyetje, si p.sh.:

- Ku jeton?
- Me kë jeton?
- Si quhet ky grup i njerëzve me të cilët jeton?
- Sa anëtarë ka familja jote?


Merren disa përgjigje, pa i komentuar.

Hapi 2: Përshkruhet fotografia që është dhënë në libër. Emërtohen të gjithë personat që janë në fotografi (nëna, babai, motra dhe vëllai), duke i lënë fëmijët të shprehën lirshëm.

Pasi të përfundojë diskutimi rreth fotografisë, nxënësit fillojnë të tregojnë për emrat e anëtarëve të familjeve të tyre.

Familja ime

Diskutoni për fotografinë e dhënë.



Unë jetoj me familjen. Familja ime përbëhet nga: nëna, babai dhe vëllai im. Ata kujdesen për mua. Në familjen time ka shumë dashuri.



- Cilët janë anëtarët e familjes sate?
- A ke motër ose vëlla?
- Çfarë moshe kanë ata?
- Çfarë profesione kanë prindërit e tu?

Fjalët kyçe: familje, anëtarë, përkujdesje, dashuri.

Familja ime

Diskutoni për fotografinë e dhënë.



Unë jetoj me familjen. Familja ime përbëhet nga: nëna, babai dhe vëllai im. Ata kujdesen për mua. Në familjen time ka shumë dashuri.



- Cilët janë anëtarët e familjes sate?
- A ke motër ose vëlla?
- Çfarë moshe kanë ata?
- Çfarë profesione kanë prindërit e tu?

Fjalët kyçe: familje, anëtarë, përkujdesje, dashuri.

Hapi 3: Lexohet informacioni në fund të librit. Këtu kuptohet se kush e përbën familjen e ngushtë.

Hapi 4: Bisedohet për profesionin dhe punët që i kryejnë prindërit, dhe shkurtimisht edhe për arsyen e punës së tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për emërtimin e anëtarëve të familjes së ngushtë dhe mënyrën e përshkrimit të profesioneve të tyre.

Detyrë:

Detyra: Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për vetveten disa prej karakteristikave të tij/saj (p.sh. gjininë, moshën, prejardhjen dhe vendin ku jeton etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetecat kryesore të shkollës: I.3, 7, III.2 ,3, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1 ,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Familja ime është e madhe

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Formon tregim me fotografitë e dhëna (nëna, babai, motra dhe vëllai);
- Dallon familjen e gjerë (gjysh, gjyshe);
- Tregon për punët që kryejnë gjyshërit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi të familjes së ngushtë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë vendosen katër fotografi dhe emërtohen ato të nënës, babait, motrës dhe vëllait. Kërkohet nga nxënësit që të formojnë disa fjali me këto fotografi. Në fund arrihet në përfundim që kjo është familja e ngushtë.

Hapi 2: Në tabelë shtohet edhe një fotografi në të cilën duket një njeri i moshuar (gjyshi). Fëmijët duhet ta identifikojnë atë. Më pas e vendosin në grup të familja e ngushtë. Kështu me radhë edhe gjyshërit e tjerë. Njohin dhe kuptojnë familjen e gjerë.

Hapi 3: Nxënësit diskutojnë për fotografinë që është dhënë në faqen e librit dhe për familjen e gjerë. Lexohet informacioni në fund të librit. Kuptohet se cili është dallimi në mes familjes së ngushtë dhe asaj të gjerë.

Familja ime është e madhe

Diskutoni për fotografinë e dhënë.



- Sa gjyshër ke?
- Çfarë moshe kanë ata?
- A jeton në familje të vogël apo të madhe?
- A punojnë gjyshërit e tu?



Përveç familjes së vogël, ne kemi edhe familjen e madhe. Ajo përbëhet nga: gjyshërit, prindërit dhe fëmijët. Është e rëndësishme që secili prej nesh ta njohë familjen e tij të madhe.

Fjalët kyçe: familje e madhe, anëtarë, gjysh, gjyshe.

Familja ime është e madhe

Diskutoni për fotografinë e dhënë.



- Sa gjyshër ke?
- Çfarë moshe kanë ata?
- A jeton në familje të vogël apo të madhe?
- A punojnë gjyshërit e tu?



Përveç familjes së vogël, ne kemi edhe familjen e madhe. Ajo përbëhet nga: gjyshërit, prindërit dhe fëmijët. Është e rëndësishme që secili prej nesh ta njohë familjen e tij të madhe.

Fjalët kyçe: familje e madhe, anëtarë, gjysh, gjyshe.

9

Hapi 4: Diskutohet për profesionin dhe punët që i kryejnë gjyshërit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për emërtimin e anëtarëve të familjes së gjerë dhe mënyrën e përshkrimit të profesioneve të gjyshërve të tyre.

Detyrë:

Detyra: Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për vetveten disa prej karakteristikave të tij/saj (p.sh. gjininë, moshën, prejardhjen dhe vendin ku jeton etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 7, III.2 ,3, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1 ,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Në familje punojnë të gjithë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Merr pjesë aktive në aktivitetin e zhvilluar në klasë;
- Përshkruan fotografitë e dhëna në libër;
- Shpreh mendimin për profesionet e anëtarëve të familjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi të familjes së gjerë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Ora fillon me një aktivitet të përsëritjes së njësies mësimore të kaluar.

Hapi 2: Ftohen nxënësit për të formuar një rreth dhe në ballë u vendoset nga një letër ngjitëse në të cilën ka të vizatuar një person, p.sh. një anëtar të familjes (nënë, babanë, motrën, vëllanë, gjyshen dhe gjyshin).

Fëmija që ka letrën të vendosur në ballë ka të drejtë t'i bëjë pyetje shokut ose shoqes që gjendet në krahun e djathtë, i cili ka të drejtë t'i përgjigjet vetëm me "po" ose "jo". P.sh.:

- A është njeri?
- A është i madh?
- A është i vogël?

Në familje punojnë të gjithë

Nëna ishte e shqetësuar se kush do ta merrte motrën e vogël nga kopshti.

- Do ta marr unë, - tha Drini. Nëna e përqafoi me dashuri.

- Bisedoni rreth situatës së dhënë.



R - espektojme njëri-tjetrin.

O - rganizojme punët.

L - uajmë së bashku.

I - nteresohe mi për detyrimet që kemi në familje.



- Përshkruaj figurat e dhëna.

- A ndihmon ti në familje?

- Çfarë pune bën secili prej anëtarëve të familjes?

- Trego një rast kur e ke ndihmuar familjen.



Në familje punojnë të gjithë. Secili ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta. Të gjithë anëtarët e familjes ndihmojnë njëri-tjetrin.

Fjalët kyçe: punë, rol, përgjegjësi.

Në familje punojnë të gjithë

Nëna ishte e shqetësuar se kush do ta merrte motrën e vogël nga kopshti.

- Do ta marr unë, - tha Drini. Nëna e përqafoi me dashuri.

- Bisedoni rreth situatës së dhënë.



R - espektojmë njëri-tjetrin.

O - rganizojmë punët.

L - uajmë së bashku.

I - nteresohe mi për detyrimet që kemi në familje.



- Përshkruaj figurat e dhëna.

- A ndihmon ti në familje?

- Çfarë pune bën secili prej anëtarëve të familjes?

- Trego një rast kur e ke ndihmuar familjen.



Në familje punojnë të gjithë. Secili ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta. Të gjithë anëtarët e familjes ndihmojnë njëri-tjetrin.

Fjalët kyçe: punë, rol, përgjegjësi.

10

Kur të gjithë të gjejnë përgjigjen për veten, formohen dy grupe, njëri me familjen e madhe dhe tjetri me të voglën.

Hapi 3: Hapen librat dhe diskutohet për fotografitë që janë të paraqitura në faqen e librit: për familjen, punët ose obligimet që ata kanë në familje.

Lexohet informacioni në fund të librit.

Hapi 4: Bisedohet për profesionet dhe punët që i kryejnë të gjithë anëtarët e familjes.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pasurinë e fjalorit, shprehjen e mendimeve dhe për përshkrimin e fotografive të dhëna.

Detyrë:

Detyra: Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për vetveten disa prej karakteristikave të tij/saj (p.sh. gjininë, moshën, prejardhjen dhe vendin ku jeton etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 7, III.2 ,3, V.5 .

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1 ,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë dhe shoqëria ime

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Zbaton rregullat e lojës;
- Diskuton për shoqëritë e ndryshme (lagje, shkollë etj.).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Lodra të ndryshme për fëmijë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjdhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Mësimi fillon me lojën “Telefoni i prishur”.

Hapi 2: Ftohen nxënësit që të formojnë një rreth. Njërit i caktohet detyra që të mendojë një fjalë, dhe atë t’ia thotë shokut a shoqes në vesh, pa e dëgjuar të tjerët. Kështu vazhdojnë me radhë, deri te nxënësi i fundit, i cili duhet ta thotë fjalën e dëgjuar me zë.

Nëse është fjala e saktë ashtu si është thënë në fillim, thonë “telefoni i ndrequr”, nëse është ndryshe, thonë “telefoni i prishur”.

Hapi 3: Përshkruajnë fotografite që janë paraqitur në faqen e librit.

Unë dhe shoqëria ime

“E vetmja mënyrë që të bësh shokë të mirë është të jesh vetë një shok i tillë.”



Ne jemi shokë dhe shoqe klase.



Unë i besoj shokut tim të ngushtë. Ne flasim për çdo gjë që na shqetëson.



Ne mësojmë së bashku.



Ne jemi shokë skuadre.

Fjalët kyçe: shokë, shoqe, besim, bashkëpunim.



Ne jemi shokë dhe shoqe lagjeje.



- Cilët janë shokët dhe shoqet e klasës?
- Si e kalon kohën me ta?
- Si ndiheni ju kur bashkëpunoni?



Çdo fëmijë ka nevojë për shoqëri. Ne mësojmë dhe argëtohemi me shokët e shoqet e klasës. Edhe detyrat i kryejmë më lehtë kur bashkëpunojmë.

Lexohen informacionet e dhëna në fund të librit. Përmes tyre nënkuptohet se secili ka shokë ose shoqe me të cilët luan, mëson e bisedon.

Hapi 4: Bisedohet për shoqërinë e ndryshme dhe për sjelljen në shoqëri.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për zbatimin e rregullave të lojës dhe për mënyrën e përshkrimit të fotografive.

Detyrë:

Detyra: Plotëson në fletore pune dhe vizaton diçka të bukur për shokun ose shoqen e klasës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të anëtarëve brenda familjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, 7, III.2 ,3, V.5 .

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1 ,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë dhe të tjerët

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton anëtarët e familjes;
- Shpreh mendimin për fotografitë e dhëna;
- Tregon për personin më të dashur në familje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi të familjes së gjerë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Vendosen në mes të tabelës një foto e një vajze dhe e një djali, përreth fotoja e nënës dhe babait, e në njërin anë prindërit e nënës, tezes dhe dajës, ndërsa në anën tjetër prindërit e babait, hallës dhe xhaxhait.

Hapi 2: Diskutohet radhazi për ta.

Hapi 3: Nxënësit shprehin mendime rreth fotografive të shfaqura në libër. Pas leximit të tekstit, ata përgjigjen në pyetjet e dhëna aty.

Unë dhe të tjerët

Familja ime më jep shumë dashuri. Të gjithë më duan dhe më mësojnë gjëra të reja. Edhe unë i dua. Në familje argëtohemi të gjithë bashkë. Kjo më bën të lumtur.



1. Për gjyshin dhe gjyshen jam mbesë ose nip.
2. Për prindërit jam bijë ose bir.
3. Për vëllanë jam motër ose vëlla.
4. Për tezen dhe dajën jam mbesë ose nip.
5. Edhe për hallën dhe xhaxhanë jam mbesë ose nip.



- Çfarë je ti për anëtarët e familjes?
- Çfarë bëjnë gjyshërit për ty?
- Po prindërit, si kujdesen për ty?

Fjalët kyçe: familja, anëtarët e saj, unë.

Unë dhe të tjerët

Familja ime më jep shumë dashuri. Të gjithë më duan dhe më mësojnë gjëra të reja. Edhe unë i dua. Në familje argëtohemi të gjithë bashkë. Kjo më bën të lumtur.



1. Për gjyshin dhe gjyshen jam mbesë ose nip.
2. Për prindërit jam bijë ose bir.
3. Për vëllanë jam motër ose vëlla.
4. Për tezen dhe dajën jam mbesë ose nip.
5. Edhe për hallën dhe xhaxhanë jam mbesë ose nip.



- Çfarë je ti për anëtarët e familjes?
- Çfarë bëjnë gjyshërit për ty?
- Po prindërit, si kujdesen për ty?

Fjalët kyçe: familja, anëtarët e saj, unë.

13

Hapi 4: Nxënësit tregojnë për personin e dashur të familjes, si dhe një ngjarje të veçantë me këtë person.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për emërtimin e anëtarëve të familjes dhe mënyrën e përshkrimit të personit më të dashur në familje.

Detyrë:

Detyra: Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të anëtarëve brenda familjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 7, III.2 ,3, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1 ,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kam nevojë për të tjerët

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Formon fjalë me shkronjat e dhëna;
- Komenton fotografitë e dhëna;
- Tregon ndonjë situatë kur e ka ndihmuar dikë në nevojë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, fotografi të ndryshme.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Shkruhen disa shkronja në tabelë, p.sh. D, K, P etj. Nxiten nxënësit që të krijojnë fjalë me kup-tim, që lidhen me nevojat e tyre, duke përdorur fjalë që fillojnë me këto shkronja.

Hapi 2: Nxënësit i komentojnë fotografitë e paraqitura në libër ose në projektor.

Hapi 3: Lexohen fjalitë e dhëna në libër. Nxënësit tregojnë nëse ato janë të përafërta me mendimet e tyre.

Hapi 4: Tregojnë ndonjë situatë kur e kanë ndihmuar dikë që ka pasur nevojë për ta.

Hapi 5: Ndahet tabela në dy pjesë dhe plotësohet bashkë me mësuesen.


Kam nevojë për të tjerët

Me këto duar,
sa e sa herë mësueses
lule i kam dhuruar!



Familja ime kujdeset për mua.

Me këto duar,
sa e sa herë nënën
ngrohtësisht e kam përqaftuar!



Ne kujdesemi për veten.



Të gjithë mund të kemi nevojë për kujdesin e të tjerëve.



Tani po rritem dhe shumë gjëra mund t'i bëj vetë.



Diskutoni me njëri-tjetrin për situatat e dhëna në tekst.
- Tregoni ndonjë situatë të ngjashme nga jeta juaj e përditshme, kur ju u keni qëndruar pranë njerëzve në nevojë, ose kur të tjerët ju kanë qëndruar juve pranë.



Unë i bëj vetë disa gjëra, por kam nevojë edhe për ndihmën e të tjerëve. Familja, mësuesi/ja dhe të tjerët janë shembull për mua. Ata bëjnë më të mirën për edukimin tim. Edhe unë mundohem t'i ndihmoj të tjerët.

Fjalët kyçe: familje, shoqëri, mësuese/mësues, përkujdesje, dashuri.

14

Kam nevojë për të tjerët

Me këto duar,
sa e sa herë mësueses
lule i kam dhuruar!



Familja ime kujdeset për mua.

Me këto duar,
sa e sa herë nënën
ngrohtësisht e kam përqaftuar!



Ne kujdesemi për veten.



Të gjithë mund të kemi nevojë për
kujdesin e të tjerëve.



Tani po rritem dhe shumë gjëra
mund t'i bëj vetë.



Diskutoni me njëri-tjetrin për situatat e dhëna në tekst.
- Tregoni ndonjë situatë të ngjashme nga jeta juaj e përditshme, kur ju u
keni qëndruar pranë njerëzve në nevojë, ose kur të tjerët ju kanë qëndruar
juve pranë.



Unë i bëj vetë disa gjëra, por kam nevojë edhe për ndihmën e të
tjerëve. Familja, mësuesi/ja dhe të tjerët janë shembull për mua.
Ata bëjnë më të mirën për edukimin tim. Edhe unë mundohem t'i
ndihmoj të tjerët.

Fjalët kyçe: familje, shoqëri, mësuese/mësues, përkujdesje, dashuri.

14

Unë kam nevojë për...	Për mua kanë nevojë...

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e formimit të
fjalëve të dhëna dhe përshkrimin e fotografive.

Detyrë:

Detyra: Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të anëtarëve brenda familjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 7, III.2 ,3, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1 ,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë ndiej...

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan fotot e marra në shportë;
- Tregon situata të ngjashme me ato në libër;
- Shpreh emocione për rastet e ndihmës së njerëzve në nevojë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shkronja të mëdha (që janë mësuar).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Në mes të klasës është vendosur një shportë, në të cilën janë të vendosura disa fotografi të ndryshme të përsëritura disa herë. Numri i fotografive është i barabartë me numrin e nxënësve në klasë. Ka fotografi të tilla, si p.sh.: një fëmijë me balona dhe figura festive; një familje duke qeshur; dy vetura të goditura mes vete; dy fëmijë duke biseduar të ngrysur etj.

Hapi 2: Fëmijët i shikojnë dhe i analizojnë për 2 minuta fotot që kanë në duar. Detyrë e tyre është që të flasin lidhur me atë fotografi. Pastaj të gjithë tregojnë çfarë po shohin, p.sh. një vajzë të lumtur duke festuar; dy makina që janë ndeshur dhe diçka e keqe u ka ndodhur etj.

Hapi 3: Nxënësit vëzhgojnë fotografite e dhëna në libër, më pas tekstet lexohen nga ana e mësueses.

Unë ndiej...

Nëse dikush ka humbur buzëqeshjen,
Nëse dikush ka humbur përkëdheljen,
Nëse dikush ka humbur këngën,
Në shkollë le të vijë menjëherë
Në një vend tok i gjen shënd e verë.




Unë ndihem e gëzuar kur e festoj ditëlindjen.



Në familjen tonë ka ngrohtësi dhe dashuri. Unë ndihem i lumtur.



Unë frikësohem kur shoh një aksident në rrugë.



Unë mërzitem kur shoh njerëz duke u grindur.



- Trego për ndjenjat e tua në situata të ndryshme.
- Lojë: mësuesi/ja përmend një nga emocionet, p.sh.: i gëzuar, i mërzitur etj., ndërsa nxënësit, me anë të mimikave të fytyrës, paraqesin emocionin.



Ndjenja është emocion dhe përjetim i brendshëm ndaj dikujt ose diçkaje.

Ndjenjë mund të jetë: një gëzim, një hidhërim, një shqetësim, lumturi, kënaqësi, frikë.

Fjalët kyçe: emocion, ndjenja, përjetim.

Unë ndiej...

Nëse dikush ka humbur buzëqeshjen,
Nëse dikush ka humbur përkëdheljen,
Nëse dikush ka humbur këngën,
Në shkollë le të vijë menjëherë
Në një vend tok i gjen shend e verë.




Unë ndihem e gëzuar kur
e festoj ditëlindjen.



Në familjen tonë ka ngrohtësi
dhe dashuri. Unë ndihem i
lumtur.



Unë frikësohem kur shoh një
aksident në rrugë.



Unë mërzitem kur shoh njerëz
duke u grindur.



- Trego për ndjenjat e tua në situata të ndryshme.
- Lojë: mësuesi/ja përmend një nga emocionet, p.sh.: i gëzuar, i mërzitur etj., ndërsa nxënësit, me anë të mimikave të fytyrës, paraqesin emocionin.



Ndjenja është emocion dhe përjetim i brendshëm ndaj dikujt ose diçkaje.
Ndjenjë mund të jetë: një gëzim, një hidhërim, një shqetësim, lumturi, kënaqësi, frikë.

Fjalët kyçe: emocion, ndjenja, përjetim.

15

Hapi 4: Nxënësit rrëfejnë ndonjë situatë kur e kanë ndihmuar dikë që ka pasur nevojë për ta.

Hapi 5: Shprehin emocionet, të cilat shënohen në tabelë, si p.sh.: i gëzuar, i lumtur, i mërzitur, i frikësuar, i trishtuar.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin dhe mënyrën e shprehjes së emocioneve në rastet kur e kanë ndihmuar dikë.

Detyrë:

Detyra: Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për vetveten disa prej karakteristikave të tij/saj (p.sh. për gjininë, moshën, prejardhjen dhe vendin ku jeton etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,7, III.2 ,3, IV.4, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë marr përgjegjësi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpreh me fjalë porositë nga kënga e dëgjuar;
- Diskuton për situatat në libër;
- Ngjyros mjetet që ka përgjegjësi t'i ketë me vete në shkollë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shkronja të mëdha (që janë mësuar).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Dëgjohe me ndalesa kënga "O buburrec", e cila gjendet në vegëzën: [youtube.com/watch?v=Y4k-TIzFOktE](https://www.youtube.com/watch?v=Y4k-TIzFOktE). Analizohet dhe komentohet teksti.

Hapi 2: Në pjesën e parë dallohen fjalët e milingonës që ia thotë buburrecit dhe punën që e kryen ky i fundit.


Hapi 3: Në ndalesën e dytë diskutohen fjalët e buburrecit me të cilat i përgjigjet milingonës duke bërë një lidhje me punët dhe përgjegjësitë e secilit.

Hapi 4: Analizohen fotot e paraqitura në libër dhe diskutohen përgjegjësitë e personave të paraqitur në foto. Lexohet mësimi i dhënë në libër.

Unë marr përgjegjësi

Drini ka dy pëllumba. Ai i pastron dhe i ushqen çdo mëngjes. Drini nuk e harron asnjëherë këtë detyrë.

Diskutoni për situatën e dhënë.



Unë kujdesem për familjen time.



Unë i bëj detyrat e shtëpisë.



Unë kujdesem për higjienën time.



- Cilat janë përgjegjësitë tuaja në familje?
- Po përgjegjësitë që keni në shkollë?
- Këndoni këngën: "O buburrec". Diskutoni, bashkë me mësuesen/in, për përgjegjësitë e buburrecit dhe të milingonës.




Përgjegjësia është detyra jonë që ta kryejmë një punë sa më mirë. Shkolla, familja dhe shoqëria kanë përgjegjësi respektimin e të drejtave tona.

Fjalët kyçe: përgjegjësi, detyrë, respekt, kujdes.

Unë marr përgjegjësi

Drini ka dy pëllumba. Ai i pastron dhe i ushqen çdo mëngjes. Drini nuk e harron asnjëherë këtë detyrë.

Diskutoni për situatën e dhënë.



Unë kujdesem për familjen time.



Unë i bëj detyrat e shtëpisë.



Unë kujdesem për higjienën time.



- Cilat janë përgjegjësitë tuaja në familje?
- Po përgjegjësitë që keni në shkollë?
- Këndoni këngën: "O buburrec". Diskutoni, bashkë me mësuesen/in, për përgjegjësitë e buburrecit dhe të milingonës.



Përgjegjësia është detyra jonë që ta kryejmë një punë sa më mirë. Shkolla, familja dhe shoqëria kanë përgjegjësi respektimin e të drejtave tona.

Fjalët kyçe: përgjegjësi, detyrë, respekt, kujdes.

16

Hapi 5: Nxënësve u shpërndahen fletët e përgatitura me mjetet që duhet t'i kenë me vete në shkollë. Ja shembulli i fletës së përgatitur:

Rrethoni mjetet që duhet t'i keni me vete në shkollë:

LAPS
LIBRA
ÇANTË
ENË KUZHINE
KËPUCË

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shprehjen e përmbajtjes së këngës dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrë:

Detyra: Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Familja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të anëtarëve brenda familjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7, II.4, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Nevojat dhe dëshirat tona

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton fotot e dhëna;
- Përshkruan me fjalë një situatë të dhënë;
- Dallon nevojat nga dëshirat.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi ilustruese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Fillimisht pyeten nxënësit:

- Çfarë po shihni në foto?


Pas emërimit diskutohet:


- Për çka i përdorim?
- Kush i përdor më shumë?
- Ku i përdorim më shpesh?

Nevojat dhe dëshirat tona

Era dhe Drini u kthyen nga shkolla të gëzuar. Ata filluan të bisedonin për nevojat dhe dëshirat e tyre. Drini tregonte që kishte nevojë për këpucë të reja, kurse Era dëshironte një trotinet.

Diskutoni për situatën e dhënë.





- Bisedoni me shokun ose shoqen për nevojat dhe dëshirat tuaja.
- Numëroni nevojat dhe dëshirat e përbashkëta që keni me njëri-tjetrin në klasë.
- Si plotësohen nevojat dhe dëshirat e anëtarëve të familjes?



Nevojat janë gjëra pa të cilat nuk mund të jetojmë. Njerëzit kanë nevojë për ushqim, veshmbathje, shtëpi etj. Dëshirat na e bëjnë jetën më të bukur. Nevojat dhe dëshirat në familje plotësohen nëpërmjet punës së përbashkët të të gjithë anëtarëve të familjes.

Fjalët kyçe: nevojë, dëshirë, familje.

Hapi 2: Diskutohen fotot e paraqitura në libër, si dhe situatat e dhëna aty. Nxënësit përgjigjen në pyetjet e parashtruara. Udhëzohen që të tregojnë për dëshirat dhe nevojat e tyre.

Hapi 3: Nxënësit shprehin një dëshirë dhe një nevojë që kanë në klasë dhe në familje.

Hapi 4: Realizohet një lojë me foto, ku secili nxënës tërheq një foto dhe e dërgon në vendin e caktuar sipas ndarjes “nevojë dhe dëshirë”. Pas përfundimit të saj, diskutohet se a është në rregull kjo ndarje e bërë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për emërtimin e fotografive, dallimin e nevojave nga dëshirat.

Detyrë:

Plotëson faqen 13 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Shtëpia ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për rëndësinë e shtëpisë në ofrimin e sigurisë dhe ngrohtësisë familjare, për funksionim të një jete normale dhe mirëqenies së tij dhe anëtarëve të tjerë të familjes në të.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.4, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë banoj...

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan mjedisin e shtëpisë ku banon;
- Dallon shtëpinë nga banesa;
- Vizaton banesën a shtëpinë ku jeton.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ngjyra, fletë vizatimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Parashtrohen pyetje, si:

- Ku banoni ju?
- Si duket shtëpia a banesa ku jetoni?

Nxënësit përshkruajnë vendin ku banojnë, si duket banesa a shtëpia e tyre.

Unë banoj...

Shtëpia ime



Banesa jonë gjendet te "Parku i Qytetit". Ajo ka dhomën e ndenjes, dy dhoma gjumi, kuzhinën dhe banjën. Ne kemi edhe një park para banesës. Të gjithë fëmijët e lagjes argëtoheni aty. Mua më pëlqen shumë banesa jonë.



- Fol për banesën ose për shtëpinë tënde.
- Në cilin mjedis ndihesh më mirë? Pse?
- A kujdesesh për mirëmbajtjen e hapësirës së saj?
- Përshkruaj ambientin brenda shtëpisë sate.
- A e di adresën e shtëpisë sate?



Ne jetojmë në shtëpi ose banesë. Të gjithë duhet ta dimë adresën e saj: vendin ku jetojmë, rrugën dhe numrin.

Fjalët kyçe: banesë, dhomë, kuzhinë, adresë.

Unë banoj...

Shtëpia ime



Banesa jonë gjendet te "Parku i Qytetit". Ajo ka dhomën e ndenjes, dy dhoma gjumi, kuzhinën dhe banjën. Ne kemi edhe një park para banesës. Të gjithë fëmijët e lagjes argëtohem aty. Mua më pëlqen shumë banesa jonë.



- Fol për banesën ose për shtëpinë tënde.
- Në cilin mjedis ndihesh më mirë? Pse?
- A kujdesesh për mirëmbajtjen e hapësirës së saj?
- Përshkruaj ambientin brenda shtëpisë sate.
- A e di adresën e shtëpisë sate?



Ne jetojmë në shtëpi ose banesë. Të gjithë duhet ta dimë adresën e saj: vendin ku jetojmë, rrugën dhe numrin.

Fjalët kyçe: banesë, dhomë, kuzhinë, adresë.

19

Hapi 2: Diskutohet rreth tekstit të dhënë në libër:

- A ju pëlqen shtëpia ku jetoni?
- Në cilin mjedis ndihesh më mirë? (dhoma e ditës, dhoma e fëmijëve, kuzhina...) Pse?
- A kujdeseni për mirëmbajtjen e shtëpisë, banesës suaj?

Hapi 3: Në tabelë paraqitet në formë të vizatuar banesa shumëkatëshe dhe shtëpia me ose pa oborr. Nxënësit, në bazë të vizatimeve, arrijnë të bëjnë dallimin në mes shtëpisë dhe banesës.

Hapi 4: Secili nxënës vizaton në fletore shtëpinë ose banesën e vet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin dhe estetikën e vizatimit të shtëpisë a banesës.

Detyrë:

Detyra: Plotëson faqen 14 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Shtëpia ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për vetveten disa prej karakteristikave të tij/saj (p.sh. gjininë, moshën, prejardhjen dhe vendin ku jeton etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Unë jetoj...

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Prezanton veten me të dhënat kryesore para shokut a shoqes;
- Dallon qytetin nga fshati;
- Ngjyros pamjen ku do të dëshironte të jetonte.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë, Arsimitimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Mësimi fillon me lojën e njohjes që është realizuar edhe në fillim të klasës së parë “Ta njohim njëri-tjetrin”.


Parashtrohen pyetjet:

- Cilët jeni ju?
- Sa vjeç jeni?
- Cili është vendi ku jetoni ju?

Nxënësit prezantohen me njëri-tjetrin (p.sh.: Jam Era; Jam gjashtë vjeçe; Jam nga Peja; Prishtina; Juniku etj.).

Unë jetoj...

Diskutoni për fotografitë e dhëna.



- Cila është vendlindja jote?
- A jeton në fshat apo në qytet?
- Çfarë të pëlqen në fshat?
- Po në qytet?
- Ku do të kishe dëshirë të jetoje? Pse?



Vendlindja është vendi në të cilin kemi lindur. Vendbanimi është vendi në të cilin jetojmë. Të dyja janë shumë të rëndësishme për ne.

Fjalët kyçe: fshat, qytet, vendbanim.

Unë jetoj...

Diskutoni për fotografitë e dhëna.



- Cila është vendlindja jote?
- A jeton në fshat apo në qytet?
- Çfarë të pëlqen në fshat?
- Po në qytet?
- Ku do të kishe dëshirë të jetoje? Pse?



Vendlindja është vendi në të cilin kemi lindur. Vendbanimi është vendi në të cilin jetojmë. Të dyja janë shumë të rëndësishme për ne.

Fjalët kyçe: fshat, qytet, vendbanim.

20

Hapi 2: Diskutohen pyetjet:

- Cili është vendi ku jetoni?
- Çfarë e dallon fshatin nga qyteti?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtuara duke emërtuar vendlindjen dhe vendbanimin e tyre, varësisht nga vijnë dhe ku jetojnë (fshati, qyteti).

Hapi 3: Përshkruajnë fotot e dhëna në libër, dhe po ashtu u përgjigjen këtyre pyetjeve:

- Çfarë e dallon fshatin nga qyteti?
- Çfarë të pëlqen në fshat?
- Po në qytet?

Hapi 4: Në fletën e përgatitur me një pamje të fshatit dhe një të qytetit, nxënësit sipas dëshirës së tyre përzgjedhin të ngjyrosin pamjen, me vendin në të cilin do të dëshironin të jetonin.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për prezantimin e bërë; për emërtimin e vendbanimit të tyre; për dallimin e qytetit nga fshati dhe saktësinë e ngjyrosjes së pamjes ku do të dëshironin të jetonin.

Detyrë:

Detyra: Plotëson faqen 15 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Shtëpia ime

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Tregon për rëndësinë e shtëpisë në ofrimin e sigurisë dhe ngrohtësisë familjare, për funksionim të një jete normale dhe mirëqenies së tij dhe anëtarëve të tjerë të familjes në të.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, II.8, III.2, IV.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rreziqet në shtëpi

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Diskuton për situatën e dhënë;
- Përshkruan rregullat e ilustruara në libër;
- Paraqet shembuj në pyetjet e parashtruara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Njeriu dhe natyra, Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u parashtrohen pyetje të tilla, si:

- Cili nga ju qëndron i vetëm në shtëpi kur prindërit janë në punë?
- Cilat janë këshillat që ju japin prindërit?

Ata i shprehin mendimet e tyre, më pas lexohet situata e dhënë.

Hapi 2: Diskutohet teksti, si dhe rregullat që janë paraqitur të ilustruara. Nxënësit udhëzohen të rrethojnë rregullën që kanë dëgjuar më rrallë pas leximit të rregullores nga mësuesja.

Rreziqet në shtëpi

Drini jeton me prindërit e tij. Kur ata nuk janë në shtëpi, e këshillojnë gjithmonë që ai të tregohet i kujdesshëm. Drini i zbaton gjithmonë këshillat e prindërve. Ai e kupton që ata e bëjnë për të mirën e tij.

Diskutoni për situatën e dhënë dhe rregullat e mëposhtme.



Kujdes! Mos e harro derën hapur! Ruaje çelësin e shtëpisë!




Kujdes! Mos e harro çezmën hapur!



Kujdes! Mos ua hap derën njerëzve të panjohur!



Kujdes! Mos e harro dritën ndezur!



Kujdes! Mund të rrëzohesh!



Kujdes! Mos luaj me zjarr!

Kujdes!





- Çfarë duhet të bësh kur del nga shtëpia?
- Pse nuk duhet t'ia hapësh derën një të panjohuri?
- Trego se si sillesh ti kur je vetëm në shtëpi.

MBAJ MEND!
Në rast rreziku, thirr këta numra:

POLICIA - 192
ZJARRFIKËSIT - 193
NDIHMA E SHPEJTË - 194



Familja ka rregulla. Të gjithë duhet t'i zbatojmë ato me përgjegjësi. Kështu do të jemi më të sigurt.

Fjalët kyçe: kujdes, siguri, mirëqenie.

22

Hapi 3: Në tabelë nxirren fotot e dhëna “Larg rrezikut”. Parashtrohen pyetje bazuar në foto, si p.sh.:

- Çfarë ndodh kur nuk tregohet kujdes me hekurin për hekurosje?
- Si duhet të veprojmë nëse shohim barna apo detergjentë të pastrimit jashtë dollapëve?

Hapi 4: Parashtrohen pyetje dhe kërkesa të tjera lidhur me mësimin në vazhdim:

- Çfarë duhet të bësh kur të dalësh nga shtëpia?
- Pse është e rrezikshme t'ia hapësh derën një të panjohuri?
- Trego se si sillesh ti kur je vetëm në shtëpi.

Pasi nxënësit t'i shprehin mendimet, në tabelë jepen numrat që duhet t'i telefonojnë ata, në rast të ndonjë rreziku, si për shembull: POLICIA-192, ZJARRFIKËSIT-193 dhe NDIHMA E SHPEJTË-194. I shënojnë të dhënat në fletët e përgatitura nga mësuesja.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shpjegimin e rregullave të ilustruara dhe dhënien e shembujve.

Detyrë:

Detyra: Plotëson faqen 16 në fletore pune (detyrat 1 dhe 3).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mënyra e jetesës dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon se si jeta e familjarëve dhe mjedisi i tyre mund të kenë qenë të ndryshëm në të kaluarën nga ajo e sotmja.

Identifikon aspekte të ndryshme të jetesës së njerëzve (kulturore, shoqërore etj.) në të kaluarën dhe sot.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, II.8, III.2, IV.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Jeta dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon shembuj nga e kaluara prej gjyshit dhe gjyshes;
- Dallon aspektet e jetës në të kaluarën nga sot;
- Përshkruan të kaluarën dhe të sotmen.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shporta, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: U parashtrohen nxënësve pyetje të tilla, si:

- Kush jeton me gjyshërit në shtëpi?
- Çfarë bisedoni zakonisht me gjyshërit tuaj?
- A bisedoni për të kaluarën me gjyshërit tuaj?

Nxënësit përmendin disa gjëra, ngjarje të së kaluarës që zakonisht i bisedojnë me gjyshërit e tyre.

Jeta dikur dhe sot

Mënyra e jetesës dikur dhe sot



Gjyshi i Erës dhe i Drinit po rrinte mendueshëm.

- Çfarë ke gjysh? - e pyetën ata.

- M'u kujtua e kaluara ime e vështirë. Në familje na mungonin shumë gjëra. Ne nuk kishim mundësi shkollimi. Na mungonte kujdesi shëndetësor dhe kishim shumë pak veshje. Po të përhapej zjarr, ishte e vështirë që të fikej,

pasi nuk kishte zjarrfikës që të na ndihmonin. Eh, sa gjëra kanë ndryshuar!

- Po, gjysh, ne sot jetojmë krejt ndryshe.



- Çfarë po u tregon gjyshi Erës dhe Drinit?

- Çfarë i ka munguar atij në të kaluarën?

- Pse Era dhe Drini sot jetojnë krejt ndryshe?

- Çfarë ka ndryshuar?




Bisedoni në klasë për figurat e dhëna dhe tregoni si kanë qenë *dikur* dhe si janë *sot*.

Dikur			
Sot			



Mjetet/pajisjet teknologjike kanë përmirësuar mënyrën e jetesës sonë.



Alo, policia? (192)

Alo, zjarrfikësit? (193)

Alo, urgjenca? (194)



Luajmë dhe argëtohemi.



Mësojmë dhe edukohemi.



Njerëzit dikur kanë pasur kushte më të vështira për jetesë. Mundësia për t'u arsimuar nuk ka qenë e lehtë. Nuk kishte shumë shkolla e institucione të tjera. Ne sot mësojmë dhe edukohemi në kushte shumë më të mira.

Fjalët kyçe: dje, sot, e kaluar, polici, urgjencë, zjarrfikës, luaj, argëtohem.

Hapi 2: Pas përshkrimit, bashkërisht diskutohet rreth tekstit të dhënë në libër, ku parashtrohen pyetjet:

- Çfarë po u tregon gjyshi Erës dhe Drinit?
- Çfarë i ka munguar atij në të kaluarën?
- Çfarë ka ndryshuar jeta juaj sot nga e kaluara (gjyshit të Erës dhe Drinit)?

Hapi 3: Gjatë diskutimit fokusi mbetet te dallimi i jetesës në të kaluarën dhe sot, duke i komentuar po ashtu fotot e dhëna nga e kaluara dhe e sotmja. Fotot ndahen në dy shporta (dikur dhe sot).



Hapi 4: Nxënësit japin përshkrime duke reflektuar nga jeta e përditshme. Në dyshe njëri përshkruan të dikurshmen, kurse tjetri të sotmen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin dhe përshkrimin e disa aspekteve të jetës nga e kaluara dhe e sotmja.

Detyrë:

Detyra: Plotëson faqen 14 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mënyra e jetesës dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:

Emërton disa nga gjërat dhe veglat që janë përdorur në të kaluarën dhe tregojnë se çfarë përdorim sot në vend të tyre (qepja me gjilpërë – makina për qepje; lëvrimi i tokës me kafshë – lëvrimi me traktor dhe mjete të tjera, mjetet e transportit, komunikimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.8, III.2, IV.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mjetet e punës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon mjetet e punës;
- Tregon përdorimin e mjeteve të punës;
- Vizaton një mjet pune që përdoret sot.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS


Hapi 1: Nxënëset u parashtrohen pyetje:

- Çfarë po shihni?
- Cilat nga këto figura të paraqitura po i njihni?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre, duke treguar se cilat figura janë të njohura për ta.

Mjetet e punës

Figurat e mëposhtme tregojnë mjetet e punës dikur dhe sot. Lidh figurat që kryejnë të njëjtën punë sipas shembullit të dhënë dhe trego çfarë di për to.



- Për çfarë na shërbejnë veglat e mësipërme?
- Si ndryshojnë ato nga njëra-tjetra?
- Cilat vegla i përdorim sot? Pse?
- Pse me veglat e sotme kryejmë punë më shpejt dhe më mirë?




Njerëzit më parë e kanë pasur më të vështirë të punojnë, për shkak të mjeteve të punës. Sot, njeriu i ka përmirësuar mjetet e punës. P.sh.: më parë është përdorur *parmenda me kalë*. Sot përdoret *traktori* etj.

Fjalët kyçe: mjete të reja, mjete të punës, përmirësim.

Mjetet e punës

Figurat e mëposhtme tregojnë mjetet e punës dikur dhe sot.
Lidh figurat që kryejnë të njëjtën punë sipas shembullit të dhënë dhe trego çfarë di për to.



- Për çfarë na shërbejnë veglat e mësipërme?
- Si ndryshojnë ato nga njëra-tjetra?
- Cilat vegla i përdorim sot? Pse?
- Pse me veglat e sotme kryejmë punë më shpejt dhe më mirë?



Njerëzit më parë e kanë pasur më të vështirë të punojnë, për shkak të mjeteve të punës. Sot, njeriu i ka përmirësuar mjetet e punës.
P.sh.: më parë është përdorur *parmenda me kalë*. Sot përdoret traktori etj.

Fjalët kyçe: mjete të reja, mjete të punës, përmirësim.

25

Hapi 2: Diskutohet rreth fotove dhe tekstit të dhënë në libër. Nxënësit udhëzohen të lidhin me shigjetë mjetet e punës që i përkasin njëra-tjetrës.

Hapi 3: Në tabelë nxirren disa foto dhe bazuar në to, pyeten nxënësit:

- Për çfarë na shërbejnë veglat e dhëna në tabelë?
- Nga se ndryshojnë ato nga njëra-tjetra?
- Cilat vegla i përdorin sot? Pse?

Hapi 4: Në fletët e shpërndara vizatojnë një mjet të punës që përdoret sot, që është më i shpejtë dhe i thjeshtë. Mësuesja po ashtu nxjerr në tabelë edhe ilustrimet që i punojnë nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e mjeteve të punës, vizatimin dhe përdorimin e tyre.

Detyrë:

Plotëson faqen 18 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mënyra e jetesës dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:

Emërton disa nga gjërat dhe veglat që janë përdorur në të kaluarën dhe tregon se çfarë përdorim sot në vend të tyre (qepja me gjilpërë – makina për qepje; lëvrimi i tokës me kafshë – lëvrimi me traktor dhe mjete të tjera; mjetet e transportit, të komunikimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.8, III.2, IV.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mjetet e transportit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton mjetet e transportit me të cilat udhëtojmë;
- Klasifikon mjetet e transportit;
- Vizaton një mjet transporti që përdorim në ujë, tokë a ajër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, fletë vizatimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimitimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Diskutohen pyetjet:

- Çfarë po shihni në foto?
- Cilat nga këto figura të paraqitura po i njihni?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre, duke treguar se cilat figura janë të njohura për ta.

Mjetet e transportit

Transporti mund të jetë: **rrugor**, **ujor** dhe **ajror**.
Shih mjetet e transportit më poshtë:



BIÇIKLETA



MOTORI



MAKINA



TRENI



QERRJA



ANIJA



AUTOBUSI



VARKA



AEROPLANI



HELIKOPTERI

- Shkruaj emrat e mjeteve të transportit në tabelat e dhëna.

Transporti rrugor

autobusi

Transporti ujor

Transporti ajror



Udhëtimet realizohen me mjete të ndryshme. Kohë më parë, njerëzit udhëtonin me kalë, karrocë, qerre etj. Sot, mjetet e udhëtimit kanë ndryshuar. Ato mund të jenë rrugore, ujore dhe ajrore. Mjete rrugore quhen ato që qarkullojnë nëpër rrugë; ujore ato që lundrojnë në ujë dhe ajrore ato që fluturojnë në ajër.

Fjalët kyçe: makinë, autobus, biçikletë, anije, qerre, aeroplan, helikopter, karrocë.

Mjetet e transportit

Transporti mund të jetë: **rrugor**, **ujor** dhe **ajror**.
Shih mjetet e transportit më poshtë:



BIÇIKLETA



MOTORI



MAKINA



TRENI



QERRJA



ANIJA



AUTOBUSI



VARKA



AEROPLANI



HELIKOPTERI

- Shkruaj emrat e mjeteve të transportit në tabelat e dhëna.

Transporti rrugor

autobusi

Transporti ujqor

Transporti ajror



Udhëtimet realizohen me mjete të ndryshme. Kohë më parë, njerëzit udhëtonin me kalë, karrocë, qerre etj. Sot, mjetet e udhëtimit kanë ndryshuar. Ato mund të jenë rrugore, ujore dhe ajrore. Mjete rrugore quhen ato që qarkullojnë nëpër rrugë; ujore ato që lundrojnë në ujë dhe ajrore ato që fluturojnë në ajër.

Fjalët kyçe: makinë, autobus, biçikletë, anije, qerre, aeroplan, helikopter, karrocë.

Hapi 2: Diskutohet rreth fotove dhe tekstit të dhënë në libër.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të emërtojnë me shkronja fotot në libër sipas pyetjes së parash-truar.

- Cilat mjete të transportit janë ujore, tokësore dhe ajrore?

P.sh. me shkronjën “T” - tokësore, me “U” - ujore, me “A” - ajrore.

Hapi 4: Pasi nxënësit t’i shprehin mendimet, në fletët e dhëna nga mësuesja, vizatojnë tri llojet e mjeteve të transportit që janë mësuar. Në tabelë vendosen edhe vizatimet të cilat i punojnë nxënësit, sipas klasifikimit që i kanë bërë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për klasifikimin, emërtimin e mjeteve të transportit dhe vizatimin e së paku një mjeti.

Detyrë:

Plotëson faqet 19 dhe 20 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mënyra e jetesës dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:

Emërton disa nga gjërat dhe veglat që janë përdorur në të kaluarën dhe tregojnë se çfarë përdorim sot në vend të tyre (qepja me gjilpërë – makina për qepje, lëvrimi i tokës me kafshë – lëvrimi me traktor dhe mjete të tjera, mjetet e transportit, të komunikimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.8, III.2, IV.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mjetet e komunikimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon mjetet e komunikimit që përdoren sot;
- Tregon mënyrën e komunikimit;
- Vizaton një mjet komunikimi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, fletë vizatimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Mësuesja i drejtohet njërit prej nxënësve: Kush mungon sot?

Pyeten nxënësit:

- Çfarë po bën me shokun a shoqen?

Mjetet e komunikimit

Imagjino sikur do t'i tregosh shokut tënd për diçka interesante që të ndodhi në fundjavë. Në të kaluarën, njerëzit zakonisht shkruanin letra. Sot ti mund t'i tregosh përmes kompjuterit ose telefonit.

Diskutoni për situatën e dhënë.

- Emërto mjetet e komunikimit.



- Si kanë komunikuar njerëzit në fillim?
- Po më pas?
- Po sot, si komunikojnë njerëzit me njëri-tjetrin?
- Si realizohet ky komunikim?



Njerëzit komunikojnë kur janë afër dhe kur janë larg. Më parë, njerëzit kanë komunikuar nëpërmjet zjarrit, borisë, daulles dhe thirrjeve. Shumë më vonë, u bë i mundur komunikimi nëpërmjet radios dhe televizorit. Sot, njerëzit përdorin mënyra të ndryshme për të komunikuar, si p.sh.: me celular, laptop etj.

Fjalët kyçe: komunikim, zjarr, bori, daulle, radio, televizor.

Mjetet e komunikimit

Imagjino sikur do t'i tregosh shokut tënd për diçka interesante që të ndodhi në fundjavë. Në të kaluarën, njerëzit zakonisht shkruanin letra. Sot ti mund t'i tregosh përmes kompjuterit ose telefonit.

Diskutoni për situatën e dhënë.

- Emërto mjetet e komunikimit.



- Si kanë komunikuar njerëzit në fillim?
- Po më pas?
- Po sot, si komunikojnë njerëzit me njëri-tjetrin?
- Si realizohet ky komunikim?



Njerëzit komunikojnë kur janë afër dhe kur janë larg. Më parë, njerëzit kanë komunikuar nëpërmjet zjarrit, borisë, daulles dhe thirrjeve. Shumë më vonë, u bë i mundur komunikimi nëpërmjet radios dhe televizorit. Sot, njerëzit përdorin mënyra të ndryshme për të komunikuar, si p.sh.: me celular, laptop etj.

Fjalët kyçe: komunikim, zjarr, bori, daulle, radio, televizor.

27

Ata shprehin mendimet e tyre duke treguar për mënyrën se si u shpreh mësuesja.

Hapi 2: Diskutohen fotot dhe teksti i dhënë në libër. Po ashtu i rrethojnë mjetet e komunikimit që përdoren sot.

Hapi 3: Në tabelë vihen ca foto të disa mjeteve të komunikimit. Parashtrihen pyetje bazuar në foto, si p.sh.:

- Cilat janë këto mjete të komunikimit?
- Si komunikonin njerëzit në fillim?
- Po tani si komunikojnë?
- Si realizohet ky komunikim?

Hapi 4: Në fletët e dhëna nga mësuesja vizatohet një mjet komunikimi i cili është përdorur dikur dhe një tjetër sot.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për njohjen dhe dallimin e mjeteve të komunikimit, si dhe vizatimin e së paku të një mjeti.

Detyrë:

Plotëson faqen 21 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mënyra e jetesës dikur dhe sot

Rezultatet e të nxënit të temës:

Emërton disa nga gjërat dhe veglat që janë përdorur në të kaluarën dhe tregon se çfarë përdorim sot në vend të tyre (qepja me gjilpërë – makina për qepje; lëvrimi i tokës me kafshë – lëvrimi me traktor dhe mjete të tjera; mjetet e transportit, të komunikimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, 3, III.2, IV.3, VI.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Një vizitë në muze

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Diskuton rreth figurës së dhënë;
- Emërton disa nga objektet që i ka parë në muze;
- Përshkruan çka ruhet në muze.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, projektor, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Pyeten nxënësit:

- Çfarë po shihni në foto, çfarë figura janë ato?
- Cilat nga këto figura të paraqitura po i njihni?

Një vizitë në muze

Muzeu është vendi ku ruhen gjëra me vlerë nga e kaluara.



- Bisedoni për figurën e dhënë. Organizoni një vizitë në muzeun historik të qytetit ose paraqitni një dokumentar me pamje nga muzeu.
- Çfarë po në muze?
- Për çfarë shërben muzeu?
- A të kanë folur prindërit ose mësuesi/ja për të kaluarën?
- A mendon se ke ndonjë gjë me vlerë që ti mund t'ia shtosh muzeut?



Muzeu na kujton të kaluarën e vendit tonë. Pamjet e muzeut na tregojnë historikun dhe kulturën e paraardhësve tanë. Duke vizituar muzeun, ne nuk do ta harrojmë kurrë të kaluarën tonë, e cila na mundëson t'i njohim më mirë veten dhe vendin ku jetojmë.

Fjalët kyçe: vlerë, muze, histori.

Një vizitë në muze

Muzeu është vendi ku ruhen gjëra me vlerë nga e kaluara.



- Bisedoni për figurën e dhënë. Organizoni një vizitë në muzeun historik të qytetit ose paraqitni një dokumentar me pamje nga muzeu.
- Çfarë pe në muze?
- Për çfarë shërben muzeu?
- A të kanë folur prindërit ose mësuesi/ja për të kaluarën?
- A mendon se ke ndonjë gjë me vlerë që ti mund t'ia shtosh muzeut?



Muzeu na kujton të kaluarën e vendit tonë. Pamjet e muzeut na tregojnë historikun dhe kulturën e paraardhësve tanë. Duke vizituar muzeun, ne nuk do ta harrojmë kurrë të kaluarën tonë, e cila na mundëson t'i njohim më mirë veten dhe vendin ku jetojmë.

Fjalët kyçe: vlerë, muze, histori.

28

Nxënësit i shprehin mendimet e tyre.

Hapi 2: Diskutohet për lidhshmërinë e gjërave që kanë parë në muze dhe fotos së dhënë në libër. Po ashtu ata emërtojnë disa nga figurat që shohin në foto apo objektet që i kanë parë në muze.

Hapi 3: Nxënësit përgjigjen në pyetjet që janë dhënë në libër. Ndërsa për pyetjen e fundit u kërkohet që ta shprehin mendimin para të tjerëve:

- A mendon se ke ndonjë gjë me vlerë që ti mund t'ia shtosh muzeut?

Hapi 4: Në fletët e shpërndara nxënësit ilustron një element që u ka lënë përshtypje, të cilat më pas vendosen në tabelë. Kështu arrihet të kuptohet se çka është muzeu: *vendi ku ruhen objektet nga e kaluara.*

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për emërtimin e disa objekteve që kanë parë në muze, si dhe për përshkrimin e atyre që ruhen në muze.

Detyrë:

Plotëson faqen 22 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshtet dhe respekton rregullat e caktuara të veprimtarive të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë dhe shoqëri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: V.5, VI.1, 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rregullat në familje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon rregulla të familjes;
- Diskuton rreth rregullave në familjet e njëri-tjetrit;
- Shpjegon rëndësinë e respektimit të rregullave në familje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Arsimitimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Të ulur në formë rrethi, bëhet bisedë me nxënësit për situatat e paraqitura në fotot e përgatitura (në tryezë; gjatë kohës së pushimit; në dhomën e ditës etj.).

- Cilën rregull përdorni në këto ambiente që po shihni?

Nxënësit i shprehin mendimet e tyre.

Rregullat në familje

Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri



Era shkoi në familjen e shokut të saj, Matit. Ata dëshironin që të dilnin të luanin jashtë, por nëna e Matit nuk i lejoi, sepse nuk ishte koha e lojës.
- Tani është koha e drekës, - tha ajo.

Diskutoni për situatën e dhënë.

- Në secilin prej katrorëve të dhënë, vendos ✓ aty ku zbatohen rregullat në familje.



Ne i vendosim gjërat në vendin e vet!

Ne respektojmë orarin e ngrënies!

Ne bashkëpunojmë për të mirën e familjes.

Ne mbajmë qetësi kur të tjerët pushojnë!

Ne respektojmë fjalët dhe mendimet e njëri-tjetrit!

- Shkruaj dy rregulla të familjes sate.



- A i respekton rregullat e familjes?
- Pse duhen zbatuar rregullat e familjes?
- A ka raste që i shkel rregullat?
- Pse duhet t'i respektojmë rregullat?



Rregull kemi kur gjërat janë në vendin e duhur dhe bëhen në kohën e duhur. Rregullat vendosen nga njerëzit dhe duhen respektuar nga të gjithë. Në rast se është shkelur ndonjë rregull, atëherë mund të pasojë ndëshkimi.

Fjalët kyçe: rregull, familje, respekt, mendim, bashkëpunim.

30

Hapi 2: Më pas diskutohet situata e dhënë në libër:

- A ju ka rastisur edhe juve e njëjta situatë?
- Si ka vepruar nëna juaj dhe si keni vepruar ju?

Nxënësit përgjigjen duke treguar secili për vetveten dhe rregullat në familjen e tij. Ata plotësojnë duke vendosur “√” aty ku zbatohen rregullat në familje.

Hapi 3: Pyeten nxënësit se sa i respektojnë dhe sa i përdorin pesë rregullat e shfaqura në libër.

Hapi 4: Në këtë pjesë nxënësit vlerësohen edhe sipas pyetjeve të parashtruara, si:

- Pse duhet të zbatohen rregullat e familjes?
- A ka raste që i shkelni rregullat?
- Cilat janë pasojat nga moszbatimi i rregullave?

Nxënësit tregojnë edhe për pasojat që mund t'i kenë nga moszbatimi i tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për njohjen dhe rëndësinë e respektimit të rregullave familjare.

Detyrë:

Plotëson faqen 23 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan rregullat e caktuara të veprimtarive të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë dhe shoqëri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4; I.5; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rregullat në shkollën tonë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon rëndësinë e respektimit të rregullave;
- Përshkruan situatat e dhëna në fotografi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hamer, ngjyra, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Paraqitet para nxënësve me projektor fotografia e shkollës dhe kërkohet prej tyre të përshkruajnë se çfarë po shohin.

Hapi 2: Bisedohet me nxënësit për pyetjet:

- A shkon në shkollë në orarin e caktuar?
- A i zbaton rregullat e klasës dhe të shkollës?
- A është i rëndësishëm respektimi i rregullave? Pse?
- A e respektoni njëri-tjetrin në shkollë?

Rregullat në shkollën tonë

Një ditë, Era e mori telefonin në shkollë. Asaj i ra zija e telefonit gjatë orës mësimore dhe, në atë moment, mësuesja ndërpreu mësimin. Ato biseduan për këtë.


Diskutoni për situatën e dhënë.



Në shkollë duhet të hyjmë me radhë.




Ne duhet ta respektojmë orarin e mësimin.



Ne e dëgjojmë mësuesen/mësuesin me vëmendje.



Ne flasim me radhë.



Ne sillemi mirë me njëri-tjetrin.

Fjalët kyçe: rregull, shkollë, klasë.



- A shkon në shkollë në orarin e caktuar?
- A i zbaton rregullat e klasës dhe të shkollës?
- A është i rëndësishëm respektimi i rregullave? Pse?
- A e respektoni njëri-tjetrin në shkollë?
- Së bashku me mësuesin/en, hartoni rregulloren e klasës dhe vendoseni atë në këndin e klasës.



Shkolla jonë ka rregulla. Rregullat na ndihmojnë që mësimi të zhvillohet siç duhet, t'i kryejmë punët të organizuar etj. Rregulloren e klasës ne e bëjmë së bashku me mësuesin/en. Ne i respektojmë rregullat e klasës dhe të shkollës. Ne e duam dhe e respektojmë mësuesin/en dhe njëri-tjetrin.

Fjalët kyçe: rregull, shkollë, klasë.

32

Hapi 3: Lexojnë dhe bisedojnë për situatën e dhënë në libër:

- Çfarë mori Era në shkollë?
- Pse u ndërpre mësimi?
- Çfarë bëri mësuesja?
- A kishte vepruar mirë Era?
- Çfarë do të bënit ju po të ishit në vendin e Erës?

Hapi 4: Nxënësit përshkruajnë ilustrimet e dhëna duke iu përgjigjur pyetjes:

- Çfarë po shohim në fotografinë e parë?

Lexohet informacioni nën fotografi.

Në të njejtën mënyrë vazhdohet edhe me 4 ilustrimet e tjera.

Hapi 5: Lexohet informacioni i dhënë në libër për rregullat dhe diskutohet me nxënësit.

- Pse janë të rëndësishme rregullat?
- Me kë e bëjmë rregulloren e klasës?

Hapi 6: Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup tregon nga dy rregulla që duhet të zbatohen në klasë dhe më pas bëhen të përgjithshme për gjithë klasën.

Hapi 7: Ndihmohen nxënësit që rregullat e treguara t'i shkruajnë në hamer. Rregullorja e klasës vendoset te këndi i klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e rëndësisë së respektimit të rregullave, për përshkrimin me fjalë të situatave të dhëna në ilustrime.

Detyrë:

Plotëson faqen 26 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri

Rezultatet e të nxënit të temës:

Pranon rëndësinë e vendosjes së rregullave dhe zbatimin e tyre në një veprimtari të caktuar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; I.4; III.2;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rregullat në mjedise të ndryshme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan ilustrimet;
- Tregon rëndësinë e zbatimit të rregullave;
- Përmend rregulla të lagjes ku jeton.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u drejtohet pyetja:

- A ju pëlqen të shkoni në park?

Pasi përgjigjen disa nxënës, shtrohet pyetja tjetër:

- Pse do t'ju pëlqente të shkonit?

Pas përgjigjeve të dhëna, ftohen nxënësit të marrin një pozicion të rehatshëm në bankë, të mbyllin sytë e të fillojnë të fantazojnë për gjërat që do të bëjnë në park. Flitet ngadalë duke ua dhënë hapësirën e nevojshme kohore për të imagjinuar.

Rregullat në mjedise të ndryshme

Qyteti ynë ka një park shumë të bukur. Një ditë, dy fëmijë këputën disa lule. Rreth e rrotull kishte shumë njerëz. Ata mbetën të habitur nga ky veprim.

Diskutoni për situatën e dhënë.



Ta mbajmë pastër mjedisin që na rrethon.




Të luajmë në vendet e duhura.



Të presim në radhë kudo që jemi.



Të kemi respekt për më të moshuarit.



Të mbajmë qetësi në teatër.



- Trego për rregullat në lagjen tënde.

- A kujdesesh që të mos i shqetësosh të tjerët në lagje?



Mjedisi është vendi ku banojnë njerëz të moshave dhe të profesioneve të ndryshme. Për një jetë sa më të mirë dhe për ta ruajtur qetësinë rreth nesh, duhet t'i respektojmë rregullat në çdo vend.

Rregullat në komunitet na ndihmojnë që të bashkëjetojmë siç duhet.

Fjalët kyçe: rregull, mjedisi, respektim.

Rregullat në mjedise të ndryshme

Qyteti ynë ka një park shumë të bukur. Një ditë, dy fëmijë këputën disa lule. Rreth e rrotull kishte shumë njerëz. Ata mbetën të habitur nga ky veprim.

Diskutoni për situatën e dhënë.



Ta mbajmë pastër mjedisin që na rrethon.




Të luajmë në vendet e duhura.



Të presim në radhë kudo që jemi.



Të kemi respekt për më të moshuarit.



Të mbajmë qetësi në teatër.



- Trego për rregullat në lagjen tënde.
- A kujdesesh që të mos i shqetësosh të tjerët në lagje?



Mjedisi është vendi ku banojnë njerëz të moshave dhe të profesioneve të ndryshme. Për një jetë sa më të mirë dhe për ta ruajtur qetësinë rreth nesh, duhet t'i respektojmë rregullat në çdo vend.

Rregullat në komunitet na ndihmojnë që të bashkëjetojmë siç duhet.

Fjalët kyçe: rregull, mjedis, respektim.

33

Zgjidhni parkun ku do të shkoni...

Zgjidhni me kë do të shkoni në park...

Imagjinojeni veten në park...

Lihen nxënësit të imagjinojnë për 2-3 minuta.

Pastaj ftohen ata që kanë dëshirë (2-3 nxënës) të shprehin para shokëve imagjinatën e tyre.

Hapi 2: U shpjegohet nxënësve se do të mësojnë një tekst që flet për rregullat në mjedise të ndryshme si dhe shkruhet titulli në tabelë.

Hapi 3: Lexohet situata e dhënë në libër dhe nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë ka qyteti ynë?
- Çfarë kishte rreth e rrotull?
- Pse mbetën të habitur njerëzit?
- A vepruan mirë fëmijët?

Hapi 4: Nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe kërkesave në libër:

- Trego për rregullat në lagjen tënde.
- A mendon për rregullin dhe qetësinë e të tjerëve në lagjen tënde?

Hapi 5: Lexohet dhe bisedohet informacioni i dhënë për mjedisin:

- Çka është mjedisi?
- Pse duhet t'i respektojmë rregullat?

Hapi 7: Nxënësit në grupe tregojnë së paku dy rregulla që duhen zbatuar në njërin nga këto mjedise: në park, në shitore, në kinema, dhe rëndësinë e zbatimit të tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin me fjalë të ilustrimeve të dhëna në libër, për rëndësinë e zbatimit të rregullave të klasës.

Detyrë:

Plotëson fletoren e punës: Rregullat në mjedise të ndryshme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan rregullat e caktuara të veprimtarive të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë dhe shoqëri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.4, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Jemi të ndryshëm, por të barabartë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon tipare të ndryshme të njerëzve;
- Përshkruan karakteristikat e përbashkëta dhe dallimet që kanë me njëri-tjetrin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletore.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Dy nxënës dalin përpara klasës dhe u kërkohet nxënësve të tjerë të tregojnë: Nga se ndryshojnë dy nxënësit e zgjedhur? Çfarë kanë të përbashkët me njëri-tjetrin?

Hapi 2: Vizatohet Diagrami i Venit, ku shkruhen karakteristikat e përbashkëta dhe dallimet e nxënësve. Ja një shembull i dhënë:



Jemi të ndryshëm, por të barabartë



Ne ndryshojmë për nga moshë.



Ne ndryshojmë për nga pamje.



Ne ndryshojmë për nga gjinia.



Dëshirat tona janë të ndryshme.



- Nga se ndryshojnë njerëzit?


- Çfarë kemi të përbashkët me njëri-tjetrin?



Njerëzit ndryshojnë nga njëri-tjetri për nga moshë, gjinia, pamja, dëshirat etj. Pavarësisht ndryshimeve, të gjithë jemi të barabartë. Çdo njeri ka të drejtë të jetë i lumtur, prandaj duhet ta respektojmë njëri-tjetrin. Shteti ka përgjegjësi për respektimin e të drejtave të njeriut.

Fjalët kyçe: moshë, gjini, pamje, dëshirë, të ndryshëm, të barabartë.


Jemi të ndryshëm, por të barabartë



Ne ndryshojmë për nga mosha.



Ne ndryshojmë për nga pamja.



Ne ndryshojmë për nga gjinia.



Dëshirat tona janë të ndryshme.



- Nga se ndryshojnë njerëzit?
- Çfarë kemi të përbashkët me njëri-tjetrin?



Njerëzit ndryshojnë nga njëri-tjetri për nga mosha, gjinia, pamja, dëshirat etj. Pavarësisht ndryshimeve, të gjithë jemi të barabartë. Çdo njeri ka të drejtë të jetë i lumtur, prandaj duhet ta respektojmë njëri-tjetrin. Shteti ka përgjegjësi për respektimin e të drejtave të njeriut.

Fjalët kyçe: moshë, gjini, pamje, dëshirë, të ndryshëm, të barabartë.

34

Hapi 3: U shpjegohet se do të mësojnë mësimin “Jemi të ndryshëm, por të barabartë” dhe udhëzohen nxënësit të vizatojnë Diagramin e Venit në fletore me karakteristikat e dhëna në tabelë.

Hapi 4: Nxënësit përshkruajnë me fjalë ilustrimin e dhënë:

- Çfarë po shohim?
- Nga se ndryshojnë njerëzit?
- Çfarë kanë të përbashkët me njëri-tjetrin?

Hapi 5: Lexohet informacioni i dhënë dhe bisedohet rreth tij.

- Pse duhet ta respektojmë njëri-tjetrin?
- Kush ka përgjegjësi për respektimin e të drejtave të njeriut?

Hapi 6: 2-3 nxënës përshkruajnë karakteristikat e përbashkëta dhe dallimet që kanë me njëri-tjetrin.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të karakteristikave të përbashkëta dhe dallimeve mes tyre.

Detyrë:

Plotëson faqen 28 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kontribuon dhe arsyeton rëndësinë e vendosjes së rregullave të nevojshme, në bashkëpunim me të tjerët, për veprimtaritë e tij të përditshme në familje, në shkollë dhe në shoqëri.

Pranon rëndësinë e vendosjes së rregullave dhe zbatimin e tyre në një veprimtari të caktuar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: I respektoj rregullat në lojë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpreh mendim për situatën e dhënë në libër;
- Përshkruan ilustrimin e dhënë;
- Tregon rëndësinë e zbatimit të rregullave të lojës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletore pune, projektor, fotografi ilustruese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Para nxënësve me anë të projektorit paraqitet një fotografi me një lojë të caktuar. Ja një shembull i dhënë:




Nxënësit përshkruajnë fotografinë duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po bëjnë fëmijët?

I respektoj rregullat në lojë

Drini, në orën e edukatës fizike, gjithmonë zihet me shokët gjatë lojës. Shokët janë të shqetësuar.

Diskutoni për situatën e dhënë. Tregoni pse janë të shqetësuar shokët e Drinit?



Këtë lojë duhet ta luajmë me orar dhe nën kujdesin e prindërve.



- A i njeh lojërat e mësipërme?
- Cila është loja që të pëlqen më shumë?
- Në oborrin e shkollës, luani njërin nga këto lojëra, duke vendosur më parë rregullat e saj.



Lojërat janë të rëndësishme për zhvillimin e trupit dhe të mendjes sonë. Ato i kanë rregullat e veta që duhen zbatuar. Kur respektohen rregullat, lojërat bëhen më të mira dhe më të sigurta.

Fjalët kyçe: lojë, respekt, kënaqësi, rregull, zbatim.

I respektoj rregullat në lojë

Drini, në orën e edukatës fizike, gjithmonë zihet me shokët gjatë lojës. Shokët janë të shqetësuar.

Diskutoni për situatën e dhënë. Tregoni pse janë të shqetësuar shokët e Drinit?



Këtë lojë duhet ta luajmë me orar dhe nën kujdesin e prindërve.



- A i njeh lojërat e mësipërme?
- Cila është loja që të pëlqen më shumë?
- Në oborrin e shkollës, luani njërin nga këto lojëra, duke vendosur më parë rregullat e saj.



Lojërat janë të rëndësishme për zhvillimin e trupit dhe të mendjes sonë. Ato i kanë rregullat e veta që duhen zbatuar. Kur respektohen rregullat, lojërat bëhen më të mira dhe më të sigurta.

Fjalët kyçe: lojë, respekt, kënaqësi, rregull, zbatim.

35

- Si zhvillohet loja?
- Cilat janë rregullat e kësaj loje?

Hapi 2: Lexohet situata e dhënë në libër dhe bisedohet rreth pyetjeve:

- Kush grindet me shokët gjatë lojës?
- Në cilën orë zihen shokët gjatë lojës?
- Pse janë të shqetësuar ata?

Hapi 3: Nxënësit përshkruajnë me fjalë ilustrimin e dhënë duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shohim?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- A i njeh lojërat e mësipërme?
- Cila është loja që të pëlqen më shumë?

Hapi 4: Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij duke iu përgjigjur pyetjeve.

- Pse janë të rëndësishme lojërat?
- Pse duhet t'i respektojmë rregullat e lojës?

Hapi 5: Zhvillohet një lojë e përbashkët në klasë, për shembull loja “Telefoni i prishur”.

Nxënësit formojnë një rreth dhe duke pëshpëritur nga veshi në vesh, përcjellin një fjalë që ka të bëjë me temën e ditës p.sh., fjalën “shkolla”.

Kur fjala arrin te fëmija i fundit në rreth, ai fëmijë duhet ta thotë fjalën që ka dëgjuar me zë të lartë. Në fund të lojës, fjala e parë dhe e fundit krahasohen.

Hapi 6: Pyeten nxënësit se cila është rregulla e kësaj loje.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shprehjen e mendimit rreth situatës së dhënë në libër; për përshkrimin e ilustrimit të dhënë dhe për rëndësinë e zbatimit të rregullave të lojërave.

Detyrë:

Plotëson faqen 29 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan dhe respekton rregullat e caktuara të veprimtarive të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë dhe shoqëri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Respektojmë njëri-tjetrin

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon ngjarje nga jeta në një situatë të vështirë;
- Përshkruan me fjalë ilustrimin e dhënë në libër;
- Vendos fjalët magjike që duhet të shkruhen në hapësirat e zbrazëta.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Lapsa me ngjyra, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Në projektor u paraqiten nxënësve ilustrime me situata të ndryshme duke e ndihmuar njëri-tjetrin.

Hapi 2: Bisedohet rreth tyre:

- Çfarë po bëjnë?
- Çfarë po kërkojnë?
- Kur kërkojnë diçka, cilat fjalë i përdorin? (Fjalët magjike)
- Kur kërkonin diçka, cila është fjala magjike që përdorni? (Të lutem!).
- Kur merrni atë që e kërkonin, cila është fjala magjike që përdorni? (Faleminderit!).

Respektojmë njëri-tjetrin

Trego një rast kur ke qenë në një situatë të vështirë. Çfarë të ka ardhur në mendje? Si ke vepruar? Pse? Shikoji fjalët në shportë dhe shkruaji ato në vendin e duhur.



- Cilat janë fjalët magjike?
- Kur i përdorin ato?
- Pse ka rëndësi përdorimi i tyre?
- Pse duhen respektuar rregullat në komunikim?




Respekt do të thotë kur nderon veten dhe të tjerët. Ndero të tjerët që të të nderojnë edhe ata ty. Ta respektojmë njëri-tjetrin është detyrë dhe përgjegjësi jona. Ne duhet t'i zbatojmë rregullat gjatë komunikimit.

Fjalët kyçe: respekt, mirësjellje, fjalë magjike.

Respektojmë njëri-tjetrin

Trego një rast kur ke qenë në një situatë të vështirë. Çfarë të ka ardhur në mendje? Si ke vepruar? Pse? Shikoji fjalët në shportë dhe shkruaji ato në vendin e duhur.



- Cilat janë fjalët magjike?
- Kur i përdorim ato?
- Pse ka rëndësi përdorimi i tyre?
- Pse duhen respektuar rregullat në komunikim?



Respekt do të thotë kur nderon veten dhe të tjerët. Ndero të tjerët që të nderojnë edhe ata ty. Ta respektojmë njëri-tjetrin është detyrë dhe përgjegjësi jona. Ne duhet t'i zbatojmë rregullat gjatë komunikimit.

Fjalët kyçe: respekt, mirësjellje, fjalë magjike.

36

- Kur ju bëni ndonjë gabim, cila është fjala magjike që përdorni? (Më fal!).

Hapi 3: Nxënësit tregojnë një ngjarje nga jeta e tyre, kur kanë qenë në situatë të vështirë.

Hapi 4: Përshkruajnë me fjalë fotografite e dhëna dhe plotësojnë hapësirat e zbrazëta me fjalët magjike:

1. Çfarë po shohim në fotografinë e parë?
2. Çfarë po i kërkon djali vajzës?
3. Cila është fjala magjike që duhet ta përdorim para se ta kërkojmë gomën? (Të lutem!).
4. Çfarë po shohim në fotografinë e dytë?
5. Kur vonohemi, cilat fjalë magjike duhet t'i përdorim? (Më fal për vonesën!).
6. Çfarë po shohim në fotografinë e tretë?
7. Çfarë po shohim në fotografinë e katërt?
8. Kur merr atë që kërkon, cila është fjala magjike që përdor? (Faleminderit!).

Hapi 5: I shpërndahet secilit nxënës nga një fletë me etiketat e plotësuara me fjalë. I gjejnë etiketat me fjalët magjike dhe i ngjyrosin ato. Ja një shembull i dhënë.

MË FALI!	FALEMINDERITI!	TË LUTEMI!
PATJETËRI!	EJA KËTUI!	JU LUMTË!

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e përshkrimit të ngjarjes dhe të ilustrimit të dhënë, si dhe plotësimin e hapësirave të zbrazëta.

Detyrë:

Fletore pune, faqe 30.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshtetur dhe respekton rregullat e caktuara të veprimtarive të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë dhe shoqëri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndhimjojmë njerëzit në nevojë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon përmes demonstrimit ndihmën që u jep njerëzve në nevojë;
- Përshtetur ilustrimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletore pune, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjdhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet para nxënësve situata e dhënë:

Imagjinojeni veten sikur jeni të ulur në autobus. Në stacionin e radhës hip një njeri i moshuar dhe në autobus nuk ka vende të lira për t'u ulur.

- Si do të vepronit ju në këtë rast?

Hapi 2: Nxënësit lexojnë dhe analizojnë fjalitë e dhëna në libër.

Hapi 3: Përgjigju në pyetjet e dhëna:

1. Çfarë po shohim në fotografitë e dhëna?
2. A kanë të moshuarit nevojë për ne?

Ndhimjojmë njerëzit në nevojë

I ndihmojmë ata që kanë nevojë në jetë apo në lojë.

Ne i ndihmojmë me dëshirë, sepse na mësuan të jemi të mirë.

- Lexo dhe analizo fjalitë e dhëna.



Të moshuarit kanë nevojë për ne.



Ne ndihmojmë njëri-tjetrin kur kemi nevojë.



Unë kujdesem për të tjerët.



Ne ndihmojmë njëri-tjetrin edhe në punët e shtëpisë.



Ne mendojmë edhe për të tjerët.



Kafshët kanë nevojë për kujdesin tonë.



- Analizoni situatat e paraqitura në tekst.
- Pse dhe kur duhet t'i ndihmojmë të tjerët?



Kur njerëzit përballen me vështirësi, të cilat nuk mund t'i tejkalojnë vetë, ne duhet t'u ofrojmë ndihmë. Edhe ne kemi nevojë për të tjerët, prandaj duhet t'i ndihmojmë ata. Kur ndihmojmë të tjerët, jo vetëm që i bëjmë ata të ndihen mirë, por ndihemi mirë edhe vetë.

Fjalët kyçe: ndihmë, dashuri, nevojë.

Ndihmojmë njerëzit në nevojë

I ndihmojmë ata që kanë nevojë në jetë apo në lojë.

Ne i ndihmojmë me dëshirë, sepse na mësuan të jemi të mirë.

- Lexo dhe analizo fjalitë e dhëna.



Të moshuarit kanë nevojë për ne.



Ne ndihmojmë njëri-tjetrit kur kemi nevojë.



Unë kujdesem për të tjerët.



Ne ndihmojmë njëri-tjetrit edhe në punët e shtëpisë.



Ne mendojmë edhe për të tjerët.



Kafshët kanë nevojë për kujdesin tonë.



- Analizoni situatat e paraqitura në tekst.
- Pse dhe kur duhet t'i ndihmojmë të tjerët?



Kur njerëzit përballen me vështirësi, të cilat nuk mund t'i tejkalojnë vetë, ne duhet t'u ofrojmë ndihmë. Edhe ne kemi nevojë për të tjerët, prandaj duhet t'i ndihmojmë ata. Kur ndihmojmë të tjerët, jo vetëm që i bëjmë ata të ndihen mirë, por ndihemi mirë edhe vetë.

Fjalët kyçe: ndihmë, dashuri, nevojë.

37

3. Si mund t'i ndihmojmë të moshuarit?
4. Si e ndihmoni njëri-tjetrit?
5. A duhet t'i ndihmojmë të tjerët?
6. A kanë nevojë kafshët për kujdesin tonë?
7. Si kujdeseni ju për kafshët?

Hapi 4: Nxënësit (2-3 nxënës) tregojnë nga një rast kur e kanë ndihmuar dikë që ka pasur nevojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për mënyrën e përshkrimit dhe shprehitë e demonstrimit të ngjarjes për të ndihmuar të tjerët.

Detyrë:

Fletore pune, faqe 31.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Rregullat në familje, në klasë dhe në shoqëri

Rezultatet e të nxënit të temës:

Flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të komunikacionit dhe identifikon disa nga rregullat e sjelljes në rrugë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 4, II.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Veprojmë së bashku - kujdesi në rrugë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Diskuton rreth situatës së dhënë në libër;
- Shpjegon domethënien e ngjyrave të semaforit;
- Shpreh mendim për rëndësinë e helmetës në ngasjen e biçikletës;
- Tregon për rolin e policit në rrugë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Njeriu dhe natyra, Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në fillim të orës nxënësit pyeten:

- Në momentin që doni ta kaloni rrugën, çfarë keni parasysh?
- Si quhen vijat e bardha ku ne e kalojmë rrugën?
- Si quhet sinjalizuesi me drita?

Lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet së bashku. Bisedohet për rëndësinë e vendosjes së rripit të sigurisë.

Veprojmë së bashku - kujdesi në rrugë

Era doli së bashku me familjen. Do ta festonin ditëlindjen e vëllait. Udhëtimi me veturë po i pëlqente shumë. Papritur, babai frenoi. Polici i ndaloj se kishin kaluar kur drita e semaforit ishte e kuqe!

Diskutoni për situatën e dhënë.



Kur semafori tregon dritën e verdhë - bëhu gati.



Kur semafori tregon dritën e gjelbër - kalo.



Kur semafori tregon dritën e kuqe - ndalo.



Policia mban rregull dhe kujdeset për sigurinë tonë.



Këmbësorët ecin në trotuar. Ne ngasim biçikletën në shtegun për çiklistë. Çdoherë e vendosim helmetën gjatë ngasjes së biçikletës.



- Cilat janë ngjyrat e semaforit dhe çfarë tregojnë ato?
- Si e kalon rrugën kur nuk ka semafor?
- Çfarë roli kanë policët në rrugë?
- Pse është e rëndësishme ta vëmë rripin e sigurimit gjatë udhëtimit me makinë?



Policia ndihmon njerëzit të ecin të sigurt në rrugë. Ne jemi të detyruar t'i respektojmë rregullat e komunikacionit.

Fjalët kyçe: polic, rregull, komunikacion, rrip, sigurim, semafor.

39

Hapi 2: Me anë të projektorit paraqitet një figurë. Pyeten nxënësit:



- Çfarë po shihni në figurë?
- Çfarë tregojnë ngjyrat e semaforit?

Hapi 3: Shfaqet figura e librit përmes projektorit dhe e përshkruajnë atë.



Pyeten nxënësit:

- Pse është me rëndësi të vendosim helmetë në kokë kur e ngasim biçikletën?

Në fund, diskutohet së bashku me nxënësit për rolin që ka polici në rrugë.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin rreth situatës së dhënë në libër; shpjegimin e domethënies së ngjyrave të semaforit dhe rolin e policit në rrugë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Festat

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan rregullat e caktuara të veprimtarive të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë dhe shoqëri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; I.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ditët e festave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon ditët e shënuara që festohen në vendin tonë;
- Përshkruan organizimin e festave në familje dhe në shkollë;
- Vizaton simbolin e një feste.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Lapsa me ngjyra, fletë A4.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit të përmendin festat që festohen në vendin tonë. Mendimet e tyre shkruhen në tabelë sipas shembullit:



1 Festat Ditët e festave

Festat janë ditë që dallohen nga ditët e tjera, sepse lidhen me një ngjarje të veçantë.



1 Qershori
Dita Ndërkombëtare
e Fëmijëve



28 Nëntori
Pavarësia e
Shqipërisë



17 Shkurti
Pavarësia e
Kosovës



21 Shtatori
Dita Ndër-
kombëtare e
Paqes



31 Dhjetori
Viti i Ri



8 Marsi
Dita e Gruas



Ditëlindja



7 Marsi
Dita e Mësuesit/es



Dita e Shkollës



- Cilat festa festohen në vendin tonë?
- Pse dita e një feste ndryshon nga ditët e tjera?
- Si ndihesh ti në ditët e festave?



Festat janë ditë të shënuara për një grup njerëzish, që festohen prej tyre. Ne festojmë shumë festa. P.sh., ti feston ditëlindjen tënde, ne festojmë 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë, gjithë shqiptarët festojnë 28 Nëntorin, Festën e Flamurit dhe të Pavarësisë së Shqipërisë, gati e gjithë bota e feston Vitin e Ri.

Fjalët kyçe: festë, urim, gëzim.



Festat Ditët e festave

Festat janë ditë që dallohen nga ditët e tjera, sepse lidhen me një ngjarje të veçantë.



1 Qershori
Dita Ndërkombëtare
e Fëmijëve



28 Nëntori
Pavarësia e
Shqipërisë



17 Shkurti
Pavarësia e
Kosovës



21 Shtatori
Dita Ndër-
kombëtare e
Paqes



31 Dhjetori
Viti i Ri



8 Marsi
Dita e Gruas



Ditëlindja



7 Marsi
Dita e Mësuesit/es



Dita e Shkollës



- Cilat festa festohen në vendin tonë?
- Pse dita e një feste ndryshon nga ditët e tjera?
- Si ndihesh ti në ditët e festave?



Festat janë ditë të shënuara për një grup njerëzish, që festohen prej tyre. Ne festojmë shumë festa. P.sh., ti feston ditëlindjen tënde, ne festojmë 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë, gjithë shqiptarët festojnë 28 Nëntorin, Festën e Flamurit dhe të Pavarësisë së Shqipërisë, gati e gjithë bota e feston Vitin e Ri.

Fjalët kyçe: festë, urim, gëzim.

40

Hapi 2: Sqarohet kuptimi i fjalës “festë”. Festat janë ditë që dallohen nga ditët e tjera, sepse lidhen me një ngjarje të veçantë, të gëzueshme.

Hapi 3: Nxënësit përshkruajnë me fjalë ilustrimin e dhënë në libër:

- Çfarë po shihni?
- A i festoni këto festa në familje?
- Përshkruani se si i festoni njërin nga këto festa në shkollë dhe në familje.
- Pse dita e një feste ndryshon nga ditët e tjera?
- Si ndiheni ju në ditët e festave?

Hapi 4: Nxënësit vizatojnë simbolin e një feste që ata e pëlqejnë më shumë. Prezantojnë para klasës punimin e tyre dhe tregojnë arsyen pse e kanë zgjedhur atë festë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për njohuritë që i kanë për festat, për saktësinë në përgjigje dhe vizatimin e simbolit të festës.

Detyrë:

Fletore pune: Tema: “Ne dhe festat”, faqe 24.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Festat

Rezultatet e të nxënit të temës:

Arsyeton rëndësinë e vendosjes së rregull-ave të nevojshme, në bashkëpunim me të tjerët, për veprimtaritë e tij të përditshme në familje, shkollë dhe shoqëri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.4, III.2, VI.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Festat në familjen time

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Formon fjalinë me shkronjat e dhëna;
- Përshkruan fotot në libër;
- Vizaton dhuratën që pëlqen ta marrë për festa.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laps, laptop, projektor, zarf me shkronja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësit u shpërndahet nëpër banka një zarf me shkronjat e mësimi: FESTAT NË FAMILJEN TIME. U kërkohet atyre të formojnë fjalinë me shkronjat që janë në zarf. (FESTAT NË FAMILJEN TIME).

Punojnë në dyshe për 10 minuta. Pastaj e lexojnë fjalinë e formuar: FESTAT NË FAMILJEN TIME.

Hapi 2: Nxënësit përshkruajnë me fjalë ilustrimet e dhëna në libër (të paraqitura me projektor).

- Çfarë po shohim në fotografinë e parë?

Festat në familjen time



Ditëlindja
Ditëlindja festohet një herë në vit. Kjo ditë është e veçantë për të gjithë. Sot, Era feston ditëlindjen.
Era, urime për ditëlindjen!
U bëfsh 100 vjeç!



Festa e Bajramit
Familja e Drinit i përket besimit islam. Sot, ata festojnë Festën e Bajramit.
Gëzuar Bajramin!



Festa e Pashkëve
Festën e Pashkëve e festojnë njerëzit e besimit katolik dhe ortodoks.
Gëzuar Pashkët!



Krishtlindjet
Familjet e krishtera për Krishtlindje përgatisin tryezën me ushqime tradicionale.
Gëzuar Krishtlindjet!



Viti i Ri
Festa e Vitit të Ri shënon përfundimin e një viti dhe ardhjen e vitit tjetër. Të gjithë e urojnë njëri-tjetrin:
"Gëzuar Vitin e Ri!"



- Si i festoni festat në familjen tuaj?
- Na trego për një festë që të ka pëlqyer!
- Si e organizuat atë?
- A ke ndihmuar në organizimin e ndonjë feste në familje? Fol për të.

Fjalët kyçe: festat, organizimi, familja.

Festat në familjen time



Ditëlindja

Ditëlindja festohet një herë në vit. Kjo ditë është e veçantë për të gjithë. Sot, Era feston ditëlindjen.
Era, urime për ditëlindjen!
U bëfish 100 vjeç!

Festa e Bajramit



Familja e Drinit i përket besimit islam. Sot, ata festojnë Festën e Bajramit.
Gëzuar Bajramin!

Festa e Pashkëve



Festën e Pashkëve e festojnë njerëzit e besimit katolik dhe ortodoks.
Gëzuar Pashkët!

Krishtlindjet



Familjet e krishtera për Krishtlindje përgatisin tryezën me ushqime tradicionale.
Gëzuar Krishtlindjet!

Viti i Ri



Festa e Vitit të Ri shënon përfundimin e një viti dhe ardhjen e vitit tjetër. Të gjithë e urojnë njëri-tjetrin:
"Gëzuar Vitin e Ri!"



- Si i festoni festat në familjen tuaj?
- Na trego për një festë që të ka pëlqyer!
- Si e organizuat atë?
- A ke ndihmuar në organizimin e ndonjë feste në familje? Fol për të.

Fjalët kyçe: festat, organizimi, familja.

41

- Cila festë është paraqitur në këtë fotografi?
- Lexohet informacioni i dhënë nën fotografi.

Në të njëjtën formë përshkruhen edhe ilustrimet e tjera.

Hapi 3: Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të librit:

1. Si i festoni festat në familjen tuaj?
2. Cila prej festave ju ka mbetur në kujtesë?
3. Si vepruat për organizimin e saj?
4. A keni ndihmuar për organizimin e ndonjë feste në familje? Flitni për të.

Hapi 4: U kërkohet të vizatojnë dhuratën që do të dëshironin ta merrnin për festa. Prezantojnë para klasës dhe tregojnë pse e kanë përzgjedhur atë festë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin në dyshe dhe saktësinë e formulimit të fjalisë, për përshkrimin e fotografive dhe estetikën e vizatimit të bërë.

Detyrë:

Plotëson faqen 25 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Unë vendos së bashku me të tjerët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Sqaron në forma të ndryshme shprehëse vendimet e veta dhe të grupit gjatë lojës dhe aktiviteteve të ndryshme në familje, shkollë etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 4, II.2, III.2, 3, IV.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fjala ime ka vlerë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon veprimin e gabuar në tekstin e lexuar;
- Shpjegon veprimet në situatat e dhëna;
- Tregon një situatë ku është vlerësuar mendimi i vet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tekst nga literatura.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjyhe amtare (shqipe), Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënëseve u tregohet një ngjarje:

Disa fëmijë po luanin në oborrin e shokut të tyre. Pas lojës ata u ulën të pushonin dhe në ato momente të gjithë hëngrën nga një akullore. Pasi i përfunduan akulloret, dy prej tyre i hodhën mbeturinat në tokë e jo në koshin e mbeturinave. Njëri nga shokët i kritikoi ata se nuk duhej ta bënin këtë gjë dhe ata e kuptuan që kishin vepruar gabim.

Hapi 2: Parashtrohen pyetjet:

- A vepruan gabim dy shokët?



Unë vendos së bashku me të tjerët

Fjala ime ka vlerë

1. Era dhe shokët e saj të klasës shkuan në piknik. Në fund të ditës, ata filluan të largoheshin pa i mbledhur mbeturinat. Era u mërzi shumë nga veprimi i shokëve të saj. Ajo u tregoi atyre se pse duhej t'i mbledhnin mbeturinat. Shokët u bindën.



2. Mësuesja kërkoi nga nxënësit t'i kallëzonin se çfarë donin të bënin për Festën e Abetares. Rrezarta propozoi të luanin një pjesë teatrale. Drini propozoi që të bënin një vallëzim vajzat dhe djemtë e klasës. Pas shumë diskutimesh, u miratua propozimi i Drinit.



- A duhet të vlerësohet gjithmonë mendimi juaj? Pse?
- Tregoni një situatë kur mendimi juaj është vlerësuar.
- Po një situatë ku mendimi juaj nuk është dëgjuar dhe respektuar?
- Pse ka ndodhur kjo?



Fëmijët duhet të shprehin mendimet e tyre. Shkolla, familja dhe shoqëria duhet të kujdesen që fëmijëve t'u sigurohet hapësira për t'u shprehur. Fjala e menduar mirë, zë vend!

Fjalët kyçe: mendim, arsyetim, zgjidhje.



Unë vendos së bashku
me të tjerët

Fjala ime ka vlerë

1. Era dhe shokët e saj të klasës shkuan në piknik. Në fund të ditës, ata filluan të largoheshin pa i mbledhur mbeturinat. Era u mërzi shumë nga veprimi i shokëve të saj. Ajo u tregoi atyre se pse duhej t'i mbledhnin mbeturinat. Shokët u bindën.



2. Mësuesja kërkoi nga nxënësit t'i kallëzonin se çfarë donin të bënin për Festën e Abetares. Rrezarta propozoi të luanin një pjesë teatrale. Drini propozoi që të bënin një vallëzim vajzat dhe djemtë e klasës. Pas shumë diskutimesh, u miratua propozimi i Drinit.



- A duhet të vlerësohet gjithmonë mendimi juaj? Pse?
- Tregoni një situatë kur mendimi juaj është vlerësuar.
- Po një situatë ku mendimi juaj nuk është dëgjuar dhe respektuar?
- Pse ka ndodhur kjo?



Fëmijët duhet të shprehin mendimet e tyre. Shkolla, familja dhe shoqëria duhet të kujdesen që fëmijëve t'u sigurohet hapësira për t'u shprehur. *Fjala e menduar mirë, zë vend!*

Fjalët kyçe: mendim, arsyetim, zgjidhje.

42

- Po të ishte ti në vend të tyre, si do të veproje?
- Po të shihje edhe ti një veprim të tillë, a do të flisje për t'u treguar që nuk duhet vepruar ashtu?

Hapi 3: Lexohen dhe diskutohen situatat e dhëna.

Hapi 4: Nxënësve u parashtrohen disa pyetje dhe kërkesa, si:

- A duhet të vlerësohet gjithmonë mendimi juaj? Pse?
- Trego një situatë kur mendimi juaj është vlerësuar.
- Trego një situatë ku mendimi juaj nuk është dëgjuar. Pse ka ndodhur kjo?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, dallimin e veprimit të gabuar në tekstin e dhënë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Unë vendos së bashku me të tjerët

Rezultatet e të nxënit të temës:

Arsyeton rëndësinë e marrjes së vendimeve të përbashkëta për aktivitete të ndryshme në klasë dhe në mjedise të ndryshme ku vepron.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 5, III.3, IV.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bashkëpunojmë dhe marrim vendime

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon të drejtën e shprehjes së mendimit;
- Diskuton rreth situatave të dhëna;
- Arsyeton vendimin e marrë për situatën në klasë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në fillim të orës, nxënësve u bëhen disa pyetje, si për shembull:

A kanë të drejtë fëmijët të shprehin mendimin e tyre?

A duhet të dëgjohet mendimi i tyre? Pse?

Hapi 2: Lexohen dhe diskutohen situatat e dhëna në libër duke iu përgjigjur pyetjeve:

- A merret parasysh mendimi yt në shkollë?
- A merret parasysh mendimi yt në familje?

Bashkëpunojmë dhe marrim vendime

Babai i kishte premtuar Drinit se do t'ia blinte biçikletën në fund të muajit. Por, një ditë, në shtëpi u prish rrobalarësja. Babai donte ta mbante fjalën e dhënë, por Drini nuk pranoi. Ai mendoi se blerja e rrobalarësës së re ishte më e rëndësishme për familjen. Të gjithë mbetën të habitur. Ata u gëzuan që Drini mendonte ashtu.



- A merret parasysh mendimi yt në shkollë?
- A merret parasysh mendimi yt në familje?
- Pse është i rëndësishëm arsyetimi i mendimit?



Ta shprehësh mendimin dhe të të dëgjohet mendimi është një e drejtë që u takon të gjithë njerëzve. Edhe fëmijët kanë të drejtë t'i shprehin mendimet e tyre. Ato mendime që kanë mbështetje të arsyeshme, duhet të merren parasysh!

Fjalët kyçe: vendim, veprim, arsyetim.

Bashkëpunojmë dhe marrim vendime

Babai i kishte premtuar Drini se do t'ia blinte biçikletën në fund të muajit. Por, një ditë, në shtëpi u prish rrobalarësja. Babai donte ta mbante fjalën e dhënë, por Drini nuk pranoi. Ai mendoi se blerja e rrobalarësës së re ishte më e rëndësishme për familjen. Të gjithë mbetën të habitur. Ata u gëzuan që Drini mendonte ashtu.



- A merret parasysh mendimi yt në shkollë?
- A merret parasysh mendimi yt në familje?
- Pse është i rëndësishëm arsyetimi i mendimit?



Ta shprehësh mendimin dhe të të dëgjohet mendimi është një e drejtë që u takon të gjithë njerëzve. Edhe fëmijët kanë të drejtë t'i shprehin mendimet e tyre. Ato mendime që kanë mbështetje të arsyeshme, duhet të merren parasysh!

Fjalët kyçe: vendim, veprim, arsyetim.

43

- Pse është me rëndësi të arsyetohet mendimi?

Hapi 3: Për të shprehur mendimin dhe për të parë se si e arsyetojnë atë, nxënësve u komunikohet se brenda 10 minutash një nxënës i klasës duhet të zgjidhet nga e gjithë klasa që të përfaqësojë klasën në një shfaqje teatrale. Ata tregojnë emrin se kush duhet të zgjidhet dhe japin arsyeime të ndryshme. P.sh.:

- Unë mendoj se duhet të zgjidhet Nora, sepse ajo na bën gjithmonë për të qeshur.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe arsyetimin e vendimit të marrë në klasë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon ndotësit kryesorë të mjedisit ku jeton (klasë, shkollë, lagje etj.) dhe demonstroi shkathtësi, në vazhdimësi, për mirëmbajtjen e tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, IV.3, 6, V.1, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 5.1, 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Ta mbrojmë mjedisin nga ndotja

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon domethënien e thënies së dhënë;
- Tregon ndotësit e mjedisit;
- Rendit veprimet e veta me mbrojtjen e mjedisit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi dhe fletë të bardha.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë shkruhet thënia:

Duke mbrojtur mjedisin, mbron shëndetin tënd!

Më pas atyre u kërkohet të shpjegojnë domethënien e kësaj thënieje. Secili i shpreh mendimet e veta.

Hapi 2: Përshkruhet fotografia e dhënë duke treguar ndotësit e mjedisit.





Mjediti, burimet dhe
zhvillimi i qëndrueshëm

Ta mbrojmë mjedisin
nga ndotja

Duke mbrojtur mjedisin, mbron shëndetin tënd!

- Analizo fjalinë e dhënë.



- Cilët janë ndotësit e natyrës?
- Çfarë ke bërë ti për ta mbrojtur natyrën?
- Imagjinoje një situatë ku natyra do të mund të fliste. Çfarë mendon se do t'u thoshte njerëzve ajo?



Ajri është i domosdoshëm për jetën, prandaj duhet ta mbajmë atë të pastër. Ajri është i pastër në vendet me gjelbërim, prandaj duhet të mbjellim sa më shumë fidanë, lule etj. Ajri i pastër ka rëndësi të madhe, veçanërisht për fëmijët. Thuaj STOP ndotjes së natyrës! Puno dhe kujdesu për një mjedis të pastër!

Fjalët kyçe: mjedis, tokë, ajër, ujë, ndotje, mbrojtje.

44

Hapi 3:



Para nxënësve shfaqet një fotografi.

Pyeten ata:

- Çfarë ke bërë ti për të mbrojtur natyrën?
- Po të fliste natyra, çfarë do t'u thoshte njerëzve?

Nxënësit japin mendimet e tyre rreth këtyre pyetjeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, shpjegimin e thënies së dhënë, dhe gjetjen e ndotësve të mjedisit në fotografinë e paraqitur.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qendrueshëm

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Vlerëson veprimet e veta që mund të ndikojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Jep shembuj për ndikimin e njeriut në mbrojtjen dhe dëmtimin e mjedisit përreth.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, IV.3, 6, V.1, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 5.1, 2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Kujdesi ndaj mjedisit

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Shpjegon fjalinë e dhënë;
- Klasifikon mbeturinat në shportat e caktuara;
- Dallon veprimet e mira dhe jo të mira në tekstin e dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, shporta të plastikës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Me anë të projektorit paraqitet një fotografi e shoqëruar me një thënie:



Duart tona ndryshojnë botën!

Kërkohet nga nxënësit që të diskutojnë rreth fjalisë së paraqitur dhe secili prej tyre shpreh mendime të ndryshme.

Hapi 2: Paraqiten para nxënësve në klasë 4 shporta të vogla të plastikës me ngjyra të ndryshme dhe kërkohet nga ta që të klasifikojnë se cilat mbeturina hidhen në cilën shportë.

Kujdesi ndaj mjedisit

Duart tona ndryshojnë botën!

Diskutoni rreth fjalisë së mësipërme.



- Trego se si ndahen mbeturinat sipas shportave.



- Pse është e rëndësishme ta ruajmë mjedisin?
- Çfarë kujdesi tregon ti për mjedisin ku jeton?
- Çfarë ngjyre kanë shportat e mbeturinave? Çfarë tregojnë këto ngjyra?



Mjedisin e ruajmë duke u kujdesur për bimët, kafshët dhe vendet në të cilat ato jetojnë: pyjet, lumenjtë, detet etj. Mbeturinat i hedhim në vendin e caktuar dhe kujdesemi që të mos i shkelim barin dhe lulet. Kur shkojmë në piknik, duhet t'i heqim mbeturinat para se të largohemi.

Fjalët kyçe: mjedis, kujdes, shportë.

Kujdesi ndaj mjedisit

Duart tona ndryshojnë botën!

Diskutoni rreth fjalisë së mësipërme.



- Trego se si ndahen mbeturinat sipas shportave.



- Pse është e rëndësishme ta ruajmë mjedisin?
- Çfarë kujdesi tregon ti për mjedisin ku jeton?
- Çfarë ngjyre kanë shportat e mbeturinave? Çfarë tregojnë këto ngjyra?



Mjedisin e ruajmë duke u kujdesur për bimët, kafshët dhe vendet në të cilat ato jetojnë: pyjet, lumenjtë, detet etj. Mbeturinat i hedhim në vendin e caktuar dhe kujdesemi që të mos i shkelim barin dhe lulet. Kur shkojmë në piknik, duhet t'i heqim mbeturinat para se të largohemi.

Fjalët kyçe: mjedis, kujdes, shportë.

45



Hapi 3: Nxënësve u lexohet një tekst: Disa fëmijë po bënin piknik në park. Ca prej tyre luanin me top, disa ujitnin lulet që i kishin afër, të tjerë ngisnin biçikletën, disa hanin ushqime të ndryshme. Pasi e përfunduan piknikun, fëmijët nuk i mbledhën mbeturinat që i kishin bërë për t'i hedhur në shportë, mirëpo i lanë ashtu dhe shkuan në shtëpi.

Nxënësit pyeten:

- Cilat janë disa nga veprimet e duhura të fëmijëve?
- Çfarë vepruan gabim fëmijët?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, shpjegimin e fjalisë së dhënë, ndarjen e mbeturinave në shportën e caktuar.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qendrueshëm

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Demonstron gatishmërinë për të ndjekur rregullat e higjienës personale dhe të mjedisit në veprimtaritë e përditshme në familje, klasë, lagje, shkollë etj.

Identifikon ndotësit kryesorë të mjedisit ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje etj.) dhe demonstron shkathtësi në vazhdimësi, për mirëmbajtjen e tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, IV.3, 6, V.1, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1, 2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kujdesem për mjedisin ku jetoj

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Shpreh mendimin për fjalinë e dhënë;
- Diskuton për situatat e dhëna;
- Përkthejnë punët që bëjnë në shtëpi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqip), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit u shkruhet një fjalë në tabelë dhe u kërkohet që të shprehin mendimin e tyre. Disa nga ato shënohen në tabelë.



Kujdesem për mjedisin ku jetoj

Era dhe Drini donin të ndihmonin në familje.

Ata po punonin për pastrimin e ambientit brenda shtëpisë.

- Unë do t'i fshij pluhurat, - tha Drini.

- Unë do t'i rregulloj shtratin, - tha Era.

Prindërit shikonin të lumtur fëmijët e tyre. Të gjithë duhet të punojmë për një mjedis të pastër.

Diskutoni për situatën e dhënë.



Rregulloj shtratin.



Fshij pluhurat në shtëpi.



Kursej ujin.



Ujit lulet çdo ditë.



Kujdesem për qenin tim.



- Si kujdesesh ti për ambientin e shtëpisë?

- Çfarë pune bën në shtëpi?

- Si kujdesesh për ambientin në lagje?



Ne duhet të kujdesemi për ambientin brenda shtëpisë dhe në lagje. Të gjithë duhet të punojmë për një mjedis të pastër. Pastërtia dhe higjiena na ndihmojnë që të kemi një jetë të shëndetshme.

Fjalët kyçe: pastërti, rregull, kujdes, higjienë.

Kujdesem për mjedisin ku jetoj

Era dhe Drini donin të ndihmonin në familje.
Ata po punonin për pastrimin e ambientit brenda shtëpisë.
- Unë do t'i fshij pluhurat, - tha Drini.
- Unë do t'i rregulloj shtrëtërit, - tha Era.
Prindërit shikonin të lumtur fëmijët e tyre. Të gjithë duhet të punojmë për një mjedis të pastër.

Diskutoni për situatën e dhënë.



Rregulloj shtratin.



Fshij pluhurat në shtëpi.



Kursej ujin.



Ujit lulet çdo ditë.



Kujdesem për qenin tim.



- Si kujdesesh ti për ambientin e shtëpisë?
- Çfarë pune bën në shtëpi?
- Si kujdesesh për ambientin në lagje?



Ne duhet të kujdesemi për ambientin brenda shtëpisë dhe në lagje. Të gjithë duhet të punojmë për një mjedis të pastër. Pastërtia dhe higjiena na ndihmojnë që të kemi një jetë të shëndetshme.

Fjalët kyçe: pastërti, rregull, kujdes, higjienë.

46

Hapi 2: U lexohet teksti i dhënë në libër, më pas diskutohet rreth situatave të dhëna në foto.

Hapi 3: Me anë të projektorit paraqiten disa fotografi të disa fëmijëve duke bërë punë të ndryshme në shtëpi.



Hapi 4: Pasi nxënësit diskutojnë rreth fotove të paraqitura, u bëhen pyetje të tilla, si:

- Si kujdesesh ti për mjedisin e shtëpisë?
- Çfarë pune bën në shtëpi?
- Si kujdesesh për mjedisin në lagjen tënde?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, shprehjen e mendimit për fjalinë e dhënë dhe punët që bëjnë në shtëpi.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qendrueshëm

Rezultatet e të nxënës të temës:

Demonstron gatishmërinë për të ndjekur rregullat e higjienës personale dhe të mjedisit në veprimtaritë e përditshme në familje, klasë, lagje, shkollë etj. Identifikon ndotësit kryesorë të mjedisit ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje etj.) dhe demonstron shkathtësi në vazhdimësi, për mirëmbajtjen e tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, IV.3, 6, V.1, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1, 2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Kujdesem për mjedisin në shkollë

Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:

- Shpreh mendimin për situatën në libër;
- Tregon për veprimet e bëra për kujdesin e mjedisit të klasës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Njeriu dhe natyra, Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Parashtrohen pyetjet dhe marrim mendimet:

- A kujdeseni ju për mjedisin e shkollës që ta mbani pastër?
- Po në klasë, si kujdeseni që klasa juaj të jetë e pastër?
- A merrni pjesë të gjithë për të qenë klasa e pastër?

Hapi 2: Lexohet teksti i dhënë në libër dhe më pas diskutohet për situatën e dhënë. Nxënësit shprehin mendimin e tyre rreth situatës në libër.

Kujdesem për mjedisin në shkollë

Në shkollën tonë erdhi një grup vizitorësh. Ata kishin dëgjuar për rregullin dhe pastërtinë që mbahej te ne.

- Si arrini të keni një mjedis kaq të pastër, - tha dikush prej tyre.
- Ne kujdesemi së bashku për mjedisin e shkollës, - u përgjigjën nxënësit njëzëri.

Diskutoni për situatën e dhënë.



Unë mbjell lule në oborrin e shkollës dhe kujdesem për to.



Unë kujdesem që t'i dorëzoj në kohë librat në bibliotekë.



Hedh mbeturinat në vendin e caktuar.



Kursej ujin në shkollë.



Ruaj orenditë e shkollës.



Kujdesem për pastërtinë e mureve të shkollës.



- Si duket ambienti në shkollën tuaj?

- Çfarë bën ti për një shkollë të pastër?

- Sille një lule në shkollë dhe, bashkë me mësuesin/en, mbille atë në oborrin e shkollës.



Duhet të kujdesemi për mjedisin në shkollë, sepse ai është i të gjithëve. Shkolla është vendi ku ne mësojmë dhe edukohemi. Ne duhet të kujdesemi që mjedisi të jetë i pastër. Prandaj, duhet t'i hedhim mbeturinat në vendet e caktuara.

Fjalët kyçe: shkollë, mirëmbajtje, kujdes, mjedisi.

Kujdesem për mjedisin në shkollë

Në shkollën tonë erdhi një grup vizitorësh. Ata kishin dëgjuar për rregullin dhe pastërtinë që mbahej te ne.
- Si arrini të keni një mjedis kaq të pastër, - tha dikush prej tyre.
- Ne kujdesemi së bashku për mjedisin e shkollës, - u përgjigjën nxënësit njëzëri.

Diskutoni për situatën e dhënë.



Unë mbjell lule në oborrin e shkollës dhe kujdesem për to.



Unë kujdesem që t'i dorëzoj në kohë librat në bibliotekë.



Hedh mbeturinat në vendin e caktuar.



Kursej ujin në shkollë.



Ruaj orenditë e shkollës.



Kujdesem për pastërtinë e mureve të shkollës.

- Si duket ambienti në shkollën tuaj?
- Çfarë bën ti për një shkollë të pastër?
- Sille një lule në shkollë dhe, bashkë me mësuesin/en, mbille atë në oborrin e shkollës.



Duhet të kujdesemi për mjedisin në shkollë, sepse ai është i të gjithëve. Shkolla është vendi ku ne mësojmë dhe edukohemi. Ne duhet të kujdesemi që mjedisi të jetë i pastër. Prandaj, duhet t'i hedhim mbeturinat në vendet e caktuara.

Fjalët kyçe: shkollë, mirëmbajtje, kujdes, mjedis.

47

Hapi 3: Shfaqen në projektor disa fotografi.



Hapi 4: Pasi nxënësit shikojnë fotografitë e shfaqura, diskutohet së bashku për veprimet e tyre:

- Hedhja e mbeturinave në vendin e caktuar;
- Kujdesi për pastërtinë e mureve;
- Ruajtja e orendive shkollore;
- Mbjellja e luleve në oborrin e shkollës.

Nxënësit tregojnë se cilat veprime i bëjnë njëjtë sikur fëmijët në fotografi.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për shprehjen e mendimit rreth situatës së dhënë dhe kujdesin në mjedisin e klasës.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qendrueshëm

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Vlerëson veprimet e veta që mund të ndikojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: V.7, VI.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Bashkëpunojmë për një mjedis të pastër

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Nxjerr rregulla për mbrojtjen e mjedisit;
- Asyeton rregullat e nxjerra.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fletë me ngjyra në formë të gjethe, të lules dhe të lumit, ngjites.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Njeriu dhe natyra, Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Ne fillimin të orës pyeten nxënësit për kujdesin ndaj mjedisit:

- A kujdeseni për pastërtinë e mjedisit ku jetoni?
- Çfarë bëni ju që mjedisi ku jetoni të jetë i pastër?

Hapi 2: Nxënësit u shpërndahet nga një trung pa gjethe dhe fletë të përgatitura në formë të gjethe, të lules dhe të reve.




Bashkëpunojmë për një mjedis të pastër

Vizatoni një trung pa gjethe. Krijoni, me ndihmën e mësuesit/es, forma të ndryshme nga letra: gjethe, re, lule ose lumë. Shkruani në to nga një këshillë për mbrojtjen e mjedisit. Ngjithini ato në trungun që keni vizatuar. Në fund, diskutoni dhe lexojni këshillat që keni shkruar.

Materialet e nevojshme:

fleta A4, fleta me ngjyra, hameri, ngjithësi dhe ngjyrat.



Fjalët kyçe: mjedis, pemë, bashkëveprim, këshillë.


48

Bashkëpunojmë për një mjedis të pastër

Vizatoni një trung pa gjethe. Krijoni, me ndihmën e mësuesit/es, forma të ndryshme nga letra: *gjethe, re, lule ose lumë*. Shkruani në to nga një këshillë për mbrojtjen e mjedisit dhe t'i vendosin ato në fletën ku ndodhet trungu.

Materialet e nevojshme:

fleta A4, fleta me ngjyra, hameri, ngjitësi dhe ngjyrat.



Fjalët kyçe: mjedis, pemë, bashkëveprim, këshillë.

48

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit që të nxjerrin me shkrim rregullat (këshillat) për mbrojtjen e mjedisit dhe t'i vendosin ato në fletën ku ndodhet trungu.

Hapi 4: Nxënësit i lexojnë dhe i arsyetojnë këshillat që kanë shënuar.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për nxjerrjen e këshillave dhe arsyetimin e tyre.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qendrueshëm

Rezultatet e të nxënit të temës:

Sqaron në forma të ndryshme shprehëse vendimet e veta dhe të grupit, gjatë lojës dhe aktiviteteve të ndryshme në familje, në shkollë etj.; Arsyeton rëndësinë e marrjes së vendimeve të përbashkëta për aktivitete të ndryshme në klasë dhe në mjedise të ndryshme ku vepron.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7, II.1, V.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Provoj veten

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan llojet e mjeteve të transportit;
- Dallon llojet e profesioneve;
- Tregon disa përgjegjësi të veta.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Njeriu dhe natyra, Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Gjatë kësaj ore nxënësit do të provojnë dhe do të sfidojnë veten me disa detyra. Të gjithë punojnë individualisht.

Ata ngjyrosin me ngjyra të ndryshme duke i dalluar mjetet e transportit rrugor, ujor dhe ajror.


Hapi 2: Nxënësit shënojnë në një tabelë tri dëshira dhe tri nevoja që ata kanë.

Nevojat	Dëshirat

Pas kësaj detyre ata vazhdojnë me një detyrë tjetër, ku duhet të dallojnë profesionet sipas punës së dhënë në tabelë. Në një anë të tabelës janë të shënuara punë të ndryshme, në anën tjetër shkruhen profesionet.

Provoj veten

1. Ngjyros me të gjelbër mjetet e transportit rrugor, me ngjyrë të kaltër mjetet e transportit ujor dhe me ngjyrë të verdhë mjetet e transportit ajror.



2. Në tabelën e mëposhtme, shkruaj tri dëshira dhe tri nevoja që ti ke:

Nevojat	Dëshirat

3. Plotëso tabelën e mëposhtme!

Puna që bën	Profesioni
Rregullon tubacionet e ujit	
Mëson të tjerët	
Pret dhe qep rrobat	
Shëron të sëmurët	

4. Në fund të fjalive, vendos D kur është *e drejtë* dhe G kur është *e gabuar*.

- Të kujdesemi për vëllezërit/motrat.
- Ta respektojmë semaforin në rrugë.
- Ta respektojmë njëri-tjetrin.
- Të bëjmë zhurmë gjatë orës së mësimi.
- T'i ndihmojmë shokët dhe shoqet kur kanë nevojë.
- Të këputim lule në lulishte.
- Të ndihmojmë në punët e shtëpisë.
- Të kujdesemi që ta mbajmë mjedisin të pastër.

5. Plotëso:



50

Hapi 3: Janë të dhëna disa fjali ku nxënësit anash saj do të shënojnë shkronjën D kur është e drejtë dhe shkronjën G kur është e gabuar. P.sh:

- Të kujdesemi për vëllanë/motrën. D

Dhe në fund në një rrjet idesh të dhënë në libër nxënësit shkruajnë për përgjegjësitë e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për dallimin e llojeve të mjeteve të transportit, profesioneve dhe përgjegjësi të veta.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Shoqëria dhe mjedisi

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Mjedisi, burimet dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: “Loja me zare”

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon njërën nga pyetjet e dhëna në mënyrë të rastësishme;
- Rikujton temat e mësuara përmes lojës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Zar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Njeriu dhe natyra, Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Gjatë kësaj ore nxënësit luajnë një lojë që quhet “loja me zare”.

Hapi 2: Me zarin e marrë në klasë, nxënësit do të luajnë. Secili nga nxënësit e hedh një herë zarin, numri që i bie e cakton edhe numrin e pyetjes së cilës duhet t’i përgjigjet.



"Loja me zare"

Për ta luajtur lojën me zare, duhet të kesh parasysh listën e pyetjeve që u përgjigjen kutive të ndryshme. Hidh zarin dhe përgjigju pyetjes që tregon numri i rënë. Më pas, do të vazhdosësh t’u përgjigjes pyetjeve, pasi shkon përpara, për aq kuti sa tregon numri i hedhur. (P.sh.: nëse herën e parë që hodhe zarin të ra 3, pra, i përgjigjes pyetjes 3. Kur e hedh zarin përsëri dhe të bie numri 4, do të shkosh te numri 7 dhe do t’i përgjigjes pyetjes 7.)



1. Prezantohu. Çfarë ke ndryshuar?
2. Këndo një këngë para shokëve të klasës.
3. Cilët janë shoqet dhe shokët e tu të rinj?
4. Shko te numri 2.
5. Fol për pemën e familjes.
6. Shko te numri 9.
7. Cila është ndjenja më e bukur që ke përjetuar këtë vit?
8. Çfarë ke mësuar të bësh vetë gjatë këtij viti?
9. Trego disa raste kur ke ndihmuar të tjerët.
10. Shko te numri 13.
11. Cili është numri i telefonit të policisë?
12. Shko te numri 15.
13. Cila është festa që të ka pëlqyer më shumë këtë vit?
14. Trego një rregull që nuk e ke respektuar.
15. Cilën të drejtë e vlerëson më shumë?
16. Trego disa përgjegjësi që ke marrë këtë vit.
17. Sa herë të është dëgjuar fjala në klasë? Po në familje?
18. Thuaj 3 gjëra që ti i ke bërë për mirëmbajtjen e mjedisit në shkollë, në familje dhe në lagje.
19. Cilat janë mjetet e komunikacionit me të cilat ke udhëtuar këtë vit?
20. Çfarë dëshiron të bëhesh kur të rritesh? Pse?

"Loja me zare"

Për ta luajtur lojën me zare, duhet të kesh parasysh listën e pyetjeve që u përgjigjen kutive të ndryshme. Hidh zarin dhe përgjigju pyetjes që tregon numri i rënë. Më pas, do të vazhdosësh t'u përgjigjesh pyetjeve, pasi shkon përpara, për aq kuti sa tregon numri i hedhur. (P.sh.: nëse herën e parë që hodhe zarin të ra 3, pra, i përgjigjesh pyetjes 3. Kur e hedh zarin përsëri dhe të bie numri 4, do të shkosh te numri 7 dhe do t'i përgjigjesh pyetjes 7.)



1. Prezantohu. Çfarë ke ndryshuar?
2. Këndo një këngë para shokëve të klasës.
3. Cilët janë shoqet dhe shokët e tu të rinj?
4. Shko te numri 2.
5. Fol për pemën e familjes.
6. Shko te numri 9.
7. Cila është ndjenja më e bukur që ke përjetuar këtë vit?
8. Çfarë ke mësuar të bësh vetë gjatë këtij viti?
9. Trego disa raste kur ke ndihmuar të tjerët.
10. Shko te numri 13.
11. Cili është numri i telefonit të policisë?
12. Shko te numri 15.
13. Cila është festa që të ka pëlqyer më shumë këtë vit?
14. Trego një rregull që nuk e ke respektuar.
15. Cilën të drejtë e vlerëson më shumë?
16. Trego disa përgjegjësi që ke marrë këtë vit.
17. Sa herë të është dëgjuar fjala në klasë? Po në familje?
18. Thuaj 3 gjëra që ti i ke bërë për mirëmbajtjen e mjedisit në shkollë, në familje dhe në lagje.
19. Cilat janë mjetet e komunikimit me të cilat ke udhëtuar këtë vit?
20. Çfarë dëshiron të bëhesh kur të rritesh? Pse?

51

Hapi 3: Nxënësit me radhë e hedhin zarin. Pas hedhjes së tij, i përgjigjen pyetjes së caktuar. Disa nga pyetjet dhe kërkesat:

- Prezanto veten.
- Cilët janë shoqet dhe shokët e tu të rinj që je shoqëruar këtë vit?
- Trego rastet kur i ke ndihmuar të tjerët.
- Thuaj 3 gjëra që ti ke bërë për mirëmbajtjen e mjedisit në shkollë, në familje dhe në lagje.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna gjatë zhvillimit të veprimtarisë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:
